

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE
Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve

SKELETKURRIKULI

Për Profilin Mësimor

**PRODHIME DRURI GJYSMË TË
GATSHME**

Niveli II

(Në drejtimin mësimor Përpunim druri)

Kodi: C2-II-18

Miratoi:

MINISTRI

Tiranë, 2018

Përmbajtja:

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, të drejtimit mësimor “Përpunim druri”

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II
2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II
3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II
4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

III. Plani mësimor për profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

IV. Udhëzime për planin mësimor

V. Udhëzime për procesin mësimor

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

IX. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

I. Qëllimet e arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II të drejtimit mësimor “Përpunim druri”.

Qëllimi kryesor i arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, të drejtimit “Përpunim druri”, është *“zhvillimi i personalitetit të nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me prodhimet e drurit gjysmë të gatshme.*

Për të realizuar këtë, shkolla profesionale u krijon nxënësve:

- mundësi të përshtatshme për të nxënë, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi dhe aftësitë;
- mundësi për të gjithë, për të zhvilluar kompetencat profesionale, të bazuara në njohuritë, shprehjet, qëndrimet dhe vlerat, të mjaftueshme për të lehtësuar punësimin dhe përparimin drejt arsimit e formimit profesional të mëtejshëm;
- mbështetje për t’u njohur me rregullat e sigurimit teknik e të ruajtjes së mjedisit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe për t’i zbatuar ato me rreptësi;
- mbështetje për t’u njohur me teknologjitë e proceset teknologjike bashkëkohore e të perspektivës, që lidhen me kualifikimin profesional përkatës;
- mbështetje për të zhvilluar ndjenjën e disiplinës, kuriozitetin intelektual dhe profesional, aftësitë sipërmarrëse, si dhe vlerat morale;
- mbështetje për t’u zhvilluar psikologjikisht dhe fizikisht, për të përballuar vështirësitë që do të ndeshin gjatë veprimtarive të ardhshme profesionale;
- mbështetje për të zhvilluar frymën e tolerancës dhe të mirëbesimit nëpërmjet përvojës së punës.

II. Profili profesional i nxënësve në përfundim të arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

1. Kërkesat e pranimit të nxënësve në arsimin profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

Në shkollat që ofrojnë arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme” niveli III në KSHKI në KSHK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë të rinjtë që:

- kanë mbaruar arsimin profesional në drejtimin mësimor “Përpunim druri”, niveli II
- janë të aftë fizikisht dhe mendërisht të përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional.
- nëse kanë aftësi të kufizuara, shkolla krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me paftësitë që shfaqin.

Në raste të veçanta kur kërkesat për të ndjekur këtë shkollim janë më të larta se kapacitetet reale të këtyre shkollave, atëherë, MFE përgatit udhëzime të veçanta me kritere të posaçme pranimi për këto shkolla.

2. Kompetencat e përgjithshme të nxënësve në përfundim të arsimit në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

- Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, nxënësi do të zotërojë këto kompetenca të përgjithshme kryesore:
- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme.

- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional.
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më efçente.
- Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror.
- Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale.
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij.
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij.
- Të organizojë drejt procesin e të nxënës të tij dhe të shfaqë gadishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës.
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar.
- Të vlerësojë dhe vetvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij.

3. Kompetencat profesionale të nxënësit në përfundim të arsimit në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

Në përfundim të arsimit profesional në profilin profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, nxënësi do të jetë i aftë të zhvillojë më tej kompetencat profesionale të fituara në nivelin e I, si dhe të ushtrtojë kompetenca të tjera profesionale, si më poshtë:

- Të konceptojë planin për hapjen e një biznesi të vogël në veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të kryejë llogaritje të thjeshta ekonomike që lidhen me veprimtaritë profesionale përkatëse.
- Të respektojë standardet e profesionit.
- Të interpretojë dokumentacionin teknik të profesionit.
- Të skicojë shenjat konvencionale të paraqitjes së pllakave, panel, qelizore, zdrukthi, kompensate dhe fibre;
- Të skicojë skema kinematike për makinat gatër vertikal dhe horizontal;
- Të skicojë skema kinematike për makinat strugane, torno për trupa;
- Të skicojë skema kinematike për makina gërshërë për skuadrim;
- Të skicojë skema kinematike për makinat e copëtimit të drurit në ashkla dhe defibrimit;
- Të skicojë skema kinematike për makina tharëse të rimesos, ashklave dhe fibrave të drurit;
- Të skicojë skema kinematike për makina të formimit të pllakës së zdrukthit dhe të fibrës drunore;
- Të organizojë vendin e punës për realizimin e proceseve të punës për prodhime druri gjysmë të gatshme.
- Të përzgjedhë materialet në sektorin e sharrimit të drurit me makinat gatër,
- Të sistemojë materialet në sektorin e prerjes plane dhe tornimit të drurit për rimeso makinat strugane dhe torno;
- Të përzgjedhë llojet e materialeve specifike në sektorin e copëtimit dhe defibrimit të drurit;

- Të përzgjedhë materialet specifike në sektorin e ngjitjes me lëndë ngjitëse të kompensatës speciale, drurit me shtresa, pllakës së fibrës;
- Të selekcionojë materialet e nevojshme në makinat e formimit;
- Të sistemojë materialet, mjetet e punës dhe instrumentet prerëse dhe matës në vendin e punës;
- Të përdorë mjetet e punës në një fabrikë të lëndës së sharruar si modele, rregjistra për gatrat, vagoneta etj;
- Të përdorë mjetet e punës në një fabrikë të prodhimit të kompensatës dhe drurit me shtresa si paisje për tharje natyrale të rimesos dekorative, pllaka metalike për formimin e paketës së kompensatës etj;
- Të përdorë mjetet e punës në një fabrikë të prodhimit të pllakës panel, pllakës së zdrukthit dhe të fibrës si paisje për përcaktim të sasisë dhe përzierjen e kimikateve, pllaka metalike për formim të qilimit me fibra dhe zdrukthe, transportierë etj.;
- Të përdorë mjetet për kontroll të punimeve në fabrikat e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri si kontrollin e parametrave të rafinimit, defibrimit, shplarjes, filtrimit të fibrave etj.;
- Të kryejë matje dhe shënime në lëndën e parë në procese të ndryshme gjatë prodhimeve të drurit gjysmë të gatshme;
- Të përdorë dhe mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës;
- Të kryejë punime në sheshet e depozitës së lëndës të parë për prodhime druri gjysmë të gatshme;
- Të kryejë punime me makinat e përpunimit të drurit;
- Të kryejë punime me makina të sharrimit të trupave në lëndë të sharruar;
- Të kryejë punime me makina të prodhimit të rimesos, kompensatës dhe drurit me shtresa sipas përdorimit;
- Të kryejë punime me makina të copëtimit të drurit në ashkla;
- Të kryejë punime me makina të defibrimit dhe rafinimit të drurit;
- Të kryejë punime në makinat tharëse të rimesos, zdruktheve prej druri dhe fibrave;
- Të kryejë punime në makinat e presimit;
- Të kryejë punime për ftohjen e kompensatës, pllakës së zdrukthit ose fibrës mbas presimit;
- Të realizojë formatizimin e prodhimeve prej druri gjysmë të gatshme;
- Të realizojë përpunimin e sipërfaqes dhe brinjëve të prodhimeve prej druri gjysmë të gatshme;
- Të kryejë marketimin e prodhimeve prej druri gjysmë të gatshme;
- Të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë e të ruajtjes së mjedisit.

4. Mundësitë e punësimit dhe të arsimimit të mëtejshëm në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

Përfundimi me sukses i arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, e pajis nxënësin me certifikatën e punonjësit të kualifikuar në këtë profil profesional. Ky arsimim i jep mundësi nxënësit t’i drejtohet tregut të punës në ndërmarrje të ndryshme që prodhojnë produkte gjysmë të gatshme prej druri, si lëndë të sharruar, rimeso, kompensatë, dru të shtresuar, pllakë panel, pllakë zdrukthi dhe fibre.

Me përfundimin e këtij niveli, nxënësi ka mundësi për vazhdimin e arsimimit në nivelin III (teknik/manaxherial) të arsimit profesional (njëvjeçar) në drejtimin/profilin përkatës, për të fituar diplomën e “Maturës shtetërore profesionale”, me mundësi për vazhdimin e studimeve universitare dhe pas të mesmes.

III. Plani mësimor për arsimin profesional në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

Plani mësimor për profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II			
Nr	Kodi	Lëndët dhe modulet mësimore	Orët javore/vjetore
			Klasa 12
A.		Lëndët e përgjithshme (Gjithsej)	8/9 (272/306)
1		Gjuhë shqipe	1
2		Letërsi	1
3		Gjuhë e huaj e parë	2
4		Gjuhë e huaj e dytë (me zgjedhje të lirë)	(1)
5		Matematikë	2
6		TIK	1
7		Edukim fizik, sporte, shëndet	1
B.		Lëndët profesionale (Gjithsej)	7 (238)
1	L-17-157-10	Bazat e sipërmarrjes	2
2	L-09-182-10	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri	1
3	L-09-183-10	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri	2
4	L-09-184-10	Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri	2
C.		Module të detyruar të praktikës profesionale (Gjithsej)	12 (408)
1	M-09-1450-18	Punime për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatshme	51
2	M-09-1451-18	Punime në makina të lëndës drunore	51
3	M-09-1452-18	Punime të lyerjes me lëndë ngjytëse dhe kimikate të tjera	51
4	M-09-1453-18	Punime të ngjytjes të materialit drunor për pllaka	51
5	M-09-1454-18	Punime për prodhimin e lëndës së sharruar	51
6	M-09-1455-18	Punime për prodhimin e pllakës panel	51
7	M-09-1456-18	Punime për përmirësimin e sipërfaqes së pllakës	51
8	M-09-1457-18	Punime përfundimtare me makina	51
D.		Modulet e praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar (Gjithsej)	3 (102)
1	M-09-498-10	Formimi i qilimit me zdrukthe dhe fibra druri	51
2	M-09-499-10	Prodhimi i pllakës së fibrës me dëndësi mesatare M.D.F	51
3	M-09-1458-18	Punime për prodhimin e rimesos dekorative	51
4	M-09-1459-18	Punime për prodhimin e kompensatës	51
		Gjithsej A+B+C+D	30/31 (1020/1054)

IV. Udhëzime për planin mësimor

Në klasën 12, viti shkollor ka gjithsej 36 javë (34 javë mësimore + 2 javë provime)

Një javë mësimore ka jo më shumë se 31 orë mësimore (teorike dhe praktike).

Një orë mësimore zgjat 45 minuta.

Kurrikuli i arsimit profesional në profilin “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, përbëhet nga 4 grupe elementesh kurrikulare:

- Lëndët e kulturës së përgjithshme, të përbashkëta për drejtimet e ndryshme të këtij niveli (programet e detajuara të tyre jepen në një dokument të veçantë të MASR).
- Lëndët e kulturës profesionale (programet e përgjithshme janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale të detyruara (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).
- Modulet e praktikave profesionale me zgjedhje të detyruar (përshkruesit e tyre janë pjesë e këtij skeletkurrikuli).

Rekomandohet që modulet e praktikës profesionale të realizohen në ndarje ditore 3 orëshe ose 6 orëshe.

V. Udhëzime për procesin mësimor

Mësuesit e lëndëve teorike profesionale dhe instruktorët e moduleve të praktikave profesionale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënësit aktiv të nxënësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të punës, të plota dhe të qëndrueshme.

E rëndësishme është që **planifikimi i mësimdhënies** të bazohet në një proces analize fillestare, i cili të marrë parasysh faktorë të tillë të rëndësishëm si, niveli i hyrjes së nxënësve, përmbajtja e hollësishme e lëndëve profesionale dhe e moduleve të praktikave profesionale të parashikuara dhe shkalla e integritit të tyre, objektivat konkretë që do të arrihen, mundësitë reale që ka shkolla për realizimin e veprimtarive mësimore etj. Për këtë planifikim duhet një bashkëpunim i ngushtë i të gjithë personelit mësimdhënës dhe drejtues të shkollës.

Elementi kyç për arritjen e suksesit në një proces të nxëni, është *motivimi i nxënësve*. Njohja e vazhdueshme e nxënësve me shkallën e përbushjes së objektivave nga ana e tyre përbën një mekanizëm të fuqishëm motivimi, i cili duhet të shihet me përparësi nga mësuesit.

Një element tjetër që ndihmon suksesin është *integrimi i teorisë me praktikën* e profesionit. Parimi i “të nxënësit duke bërë” duhet të gjejë vendin e duhur në procesin e të mësuarit në shkollat profesionale të profilit mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II. Mësuesit dhe instruktorët duhet të përdorin metoda të tilla të të mësuarit që zhvillojnë jo vetëm njohuritë teorike, shkathtësitë dhe shprehitë praktike të nxënësve, por edhe qëndrimet e tyre ndaj jetës, punës dhe shoqërisë në përgjithësi. *Puna në grup* dhe *Puna me projekte* janë dy nga format bazë të organizimit të mësimin (teorik ose praktik) për të zhvilluar *kompetencat kyçe*, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë profesionale në veçanti dhe jetën e profesionistit të ardhshëm, në përgjithësi.

Një parim tjetër që duhet respektuar nga mësuesit dhe instruktorët është fakti që *të nxënësit nuk ndodh vetëm në mjediset e shkollës, por edhe jashtë tyre*. Dhënia e detyrave dhe puna kërkimore e pavarur e nxënësve ka një ndikim të dukshëm në formimin e tyre si profesionistë të ardhshëm të profilit profesional “Prodhime druri gjysmë të gatshme”.

VI. Udhëzime për vlerësimin dhe provimet

Vlerësimi vjetor i nxënësve në lëndët teorike profesionale dhe modulet e praktikave profesionale bëhet nga vetë mësuesit dhe instruktorët përkatës, me metoda dhe instrumente vlerësimi të përgatitura ose përzgjedhura nga vetë ata. Vlerësimi i nxënësve të bëhet me nota (4-10) si për lëndët teorike, ashtu edhe për modulet praktike, si gjatë vitit, ashtu edhe në provimet përfundimtare.

Në përfundim të klasës së 12-të, nxënësi i arsimuar në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, i nënshtrohet provimeve të mëposhtme:

- a) Provimi i teorisë profesionale të integruar;
- b) Provimi i praktikës profesionale të integruar;

Në këto provime ata vlerësohen për shkallën e përvetësimit të kompetencave profesionale (njohurive, shprehive, vlerave dhe qëndrimeve) të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën e prodhimeve prej druri gjysmë të gatshme, dhe u jepet certifikata në të cilën evidentohen notat përfundimtare të lëndëve teorike profesionale, të moduleve të praktikës profesionale, të lëndëve të përgjithshme, si dhe rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VII. Të dhëna për certifikatën që fitohet në përfundim të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II

Me përfundimin e suksesshëm të arsimit profesional në profilin mësimor “Prodhime druri gjysmë të gatshme”, niveli II, shkolla profesionale e pajis nxënësin me Dëftesën e përfundimit të këtij niveli si dhe me Certifikatën e aftësimit profesional, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Sipas modelit të miratuar nga MFE, këto dëshmi përmbajnë:

- a) Të dhënat për nxënësin, shkollën, vitin e përfundimit, kualifikimin e fituar etj.;
- b) Të dhëna për rezultatet e arritura nga nxënësi;
- c) rezultatet në lëndët e përgjithshme, lëndët profesionale dhe modulet profesionale;
- d) rezultatet e dy provimeve përfundimtare të nivelit II.

VIII. Programet e përgjithshme të lëndëve teorike profesionale

1. Lënda “Bazat e sipërmarrjes” (L-17-157-10). Kl. 12 – 68 orë

- Synimet e lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl. 12.

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12, nxënësit duhet:

- Të shpjegojnë sipërmarrjen me të gjithë elementet kryesore të saj;
- Të shpjegojnë lidhjen midis sipërmarrjes dhe veprimtarisë njerëzore;
- Të shpjegojnë ndikimin e sipërmarrjes në biznes;
- Të shpjegojnë funksionet themelore të organizimit të punës në biznes;
- Të përshkruajnë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të përshkruajnë llojet e konsumatorëve, kërkesat specifike për mallra/shërbime dhe reagimet e tyre ndaj sinjaleve të marketingut të një sipërmarrjeje;
- Të shpjegojnë kuptimin e institucioneve financiare dhe rolin e tyre në biznes;
- Të shpjegojnë funksionimin e bankave dhe shërbimet e tyre;
- Të shpjegojnë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të listojnë katër “P”-të e marketingut ;
- Të përshkruajnë konceptet bazë të legjislacionit dhe etikës së biznesit;
- Të shpjegojnë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementet përbërëse të tij;
- Të kryejnë llogaritje të thjeshta ekonomike të një veprimtarie sipërmarrëse;
- Të shpjegojnë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes.

- Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës “Bazat e sipërmarrjes”, kl.12 - 68 orë

Tema 1	Njohuri të përgjithshme mbi sipërmarrjen	3 orë
Tema 2	Sipërmarrja dhe veprimtaria njerëzore	4 orë
Tema 3	Sipërmarrja dhe biznesi	8 orë
Tema 4	Organizimi i punës në biznes	9 orë
Tema 5	Tregu dhe sjellja konsumatore	6 orë
Tema 6	Institucionet financiare	7 orë
Tema 7	Njohuri për marketingun	5 orë
Tema 8	Legjislacioni dhe etika e biznesit	5 orë
Tema 9	Legjislacioni i punës	7 orë
Tema 10	Llogaritje të thjeshta ekonomike	10 orë
Tema 11	Aspekte të TIK-ut në biznes	4 orë

2. Lënda ”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri” (L-09-182-10). Kl. 12- 34 orë”

- Synimet e lëndës ”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri”, kl. 12

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri” kl. 12 nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të lëndës të sharruar dhe vendosjen e makinave sipas operacioneve të punës.
 - Të llogaritin vëllimin e trupave.
 - Të shpjegojnë ndarjen e trupave sipas cilësisë dhe përmasave.
 - Të llogarisin sipërfaqen e depozitës të trupave.
 - Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të prodhimtarisë dhe normativës së lëndës të parë për lëndën e sharruar.
 - Të përcaktojnë metodat e sharrimit të trupave.
 - Të përcaktojnë modelin e prerjes.
 - Të përgatisin shabllonet në vartësi të trashësisë të lëndës të sharruar.
 - Të klasifikojnë makinat e sharrimit të trupave.
 - Të shpjegojnë vecoritë e gatërit vertikal nga ai horizontal.
 - Të lexojnë skemën e punës të makinës gatër vertikal.
 - Të rendisin pjesët fikse dhe të lëvizëshme të gatërit vertikal.
 - Të përshkruajnë ndërtimin dhe funksionin e secilës pjesë të gatërit.
 - Të lexojnë skemat e punës të mekanizmit të avancit të trupit në gatër.
 - Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionin e pajisjeve të gatërit.
 - Të përshkruajnë vecoritë e ndërtimit dhe funksionimit të sharrave për prerje të trupave.
 - Të lexojnë skemat e punës të makinave të sharrimit për prerje të trupave.
 - Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat e sharrimit të trupave.
 - Të shpjegojnë karakteristikat e makinave të sharrimit të trupave.
 - Të shpjegojnë karakteristikat e instrumentave të sharrimit të trupave.
 - Të listojnë dhe shpjegojnë operacionet e mirëmbajtjes të instrumentave të sharrimit të trupave.
 - Të shpjegojnë mënyrën e matjes dhe llogaritjes të vëllimit të dërrasave, markëtimin e tyre.
 - Të tregojnë mekanizmat që përdoren në sheshin e lëndës të sharruar.
 - Të përshkruajnë mënyrën e stivimit të lëndës të sharruar.
 - Të llogarisin sipërfaqen e depozitës të lëndës të sharruar.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej druri” kl. 12- 34 orë**

Tema 1	Teknologjia e prodhimit të lëndës të sharruar	2 orë
Tema 2	Depozita e trupave dhe organizimi	4 orë
Tema 3	Metodat e sharrimit të trupave	5 orë
Tema 4	Makina gatër	5 orë
Tema 5	Pajisjet e gatërit	5 orë
Tema 6	Përgatitja e gatërit për punë	5 orë
Tema 7	Makina sharrë shirit dhe disk për trupa	4 orë
Tema 8	Instrumenta prerës të sharrimit dhe mirëmbajtja e tyre	4 orë

3. Lënda “Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri” (L-09-183-10). Kl. 11 - 68 orë

- Synimet e lëndës ”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri”, kl. 12 - 68 orë

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri” nxënësit duhet:

- Të renditin dhe dallojnë prodhimet gjysmë të gatshme prej fletësh druri.
- Të shpjegojnë mënyrën e organizimit të depozitës të trupave për rimeso dhe kompensatë.
- Të shpjegojnë rëndësinë e trajtimit hidrotermik të trupave për rimeso dhe kompensatë.
- Të dallojnë metodat e trajtimit termik dhe vecoritë e tyre.
- Të shpjegojnë mënyrën e përcaktimit të parametrave të regjimit të trajtimit termik, duke patur parasysh faktorët që ndikojnë në to.
- Të përshkruajnë procese të përgatitjes të trupave për t’u punuar si heqja e lëvores, përcaktimi i qëndrës etj.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të rimesos dekorative, vendosjen e makinave sipas operacioneve të punës.
- Të shpjegojnë mënyrat e prerjes të drurit për prodhimin e rimesos.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës gatër horizontal.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën gatër horizontal.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës strugane horizontale.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën strugane horizontale.
- Të dallojnë makinën strugane horizontale nga ajo vertikale.
- Të dallojnë karakteristikat e thikës dhe kondra thikës të makinës strugane.
- Të shpjegojnë metodat e prodhimit të rimesos në pllaka të plota dhe gjysmë pllaka.
- Të shpjegojnë faktorët që ndikojnë në prodhimtarinë e makinës strugane.
- Të shpjegojnë rëndësinë e proceseve përfundimtare të prodhimit të rimesos dekorative.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës torno.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën torno.
- Të përshkruajnë procesin e prodhimit të fijeve me tornim duke dalluar faktorët që ndikojnë në të si pozicioni i thikes, kondrathikës, shpejtësia e prerjes gjatë tornimit dhe rregullimi i saj.
- Të dallojnë defektet e fletëve gjatë tornimit, shkaqet dhe mënyrat e evitimit të tyre.
- Të shpjegojnë rëndësinë e tharjes të rimesos dekorative dhe teknike.
- Të dallojnë metodat e tharjes të rimesos dhe vecoritë e tyre.
- Të tregojnë rëndësinë e ndjekjes të regjimit të tharjes, parametrat e tij dhe faktorët që ndikojnë në to.
- Të dallojnë defektet e fletëve të kompensatës gjatë tharjes, shkaqet dhe mënyrat e evitimit të tyre.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të bringjitjes të rimesos.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e bringjitjes të rimesos.
- Të rendisin dhe shpjegojnë faktorët që ndikojnë në cilësinë e ngjitjes të fijeve të rimesos teknike për prodhimin e kompensatës.
- Të dallojnë lëndët ngjitëse që përdoren për ngjitjen e fijeve të kompensatës.

- Të përshkruajnë recetat e përgatitjes të lëndëve ngjitëse për kompensatën.
 - Të lexojnë skemën e punës të makinave të lyerjes të rimesos me lëndë ngjitëse.
 - Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e lyerjes të rimesos me lëndë ngjitëse.
 - Të përshkruajnë rëndësinë e procesit të presimit për kompensatën, regjimin e presimit dhe faktorët që ndikojnë në parametrat e regjimit.
 - Të lexojnë skemën e punës të makinës presë
 - Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën presë.
 - Të shpjegojnë difektet e kompensatës gjatë presimit shkaqet dhe mënyrat e evitimit.
 - Të rendisin operacionet përfundimtare të teknologjisë të prodhimit të kompensatës.
 - Të dalojnë vecoritë e teknologjisë të prodhimit të kompensatove për mjedise të jashtëme, për aviacion, e valëzuar, e blinduar, e armuar dhe me vizatime.
 - Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të drurit të shtresuar.
- **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme prej fletësh druri” kl. 12- 68 orë**

Tema 1	Veçoritë e prodhimeve gjysmë të gatshme me fletë druri,	2 orë
Tema 2	Lënda e parë për prodhimin e rimesos, kompensatës	9 orë
Tema 3	Trajtimi termik i lëndës të parë	6 orë
Tema 4	Teknologjia e prodhimit të rimesos dekorative	3 orë
Tema 5	Prodhimi i pllakave për rimeso	4 orë
Tema 6	Prodhimi i rimesos dekorative, makinat strugane	6 orë
Tema 7	Procese përfundimtare në prodhimin e rimesos	5 orë
Tema 8	Teknologjia e prodhimit të fletëve të kompensatës	5 orë
Tema 9	Procesi i prodhimit të fijeve me tornim	9 orë
Tema 10	Teknologjia e prodhimit të kompensatës	7 orë
Tema 11	Tharja e fletëve të rimesos teknike	5 orë
Tema 12	Teknologjia e prodhimit të kompensatove speciale	3 orë
Tema 13	Teknologjia e prodhimit të drurit me shtresa	4 orë

4. Lënda “Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri” (L-09-184-10). Kl. 12 – 68 orë

- **Synimet e lëndës”Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri”, kl. 12 -68 orë**

Në përfundim të trajtimit të lëndës “Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri” nxënësit duhet:

- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të pllakës të zdrukthit dhe vendosjen e makinave sipas operacioneve të punës.
- Të shpjegojnë mënyrën e përgatitjes dhe përpunimit të lëndës të parë.
- Të përshkruajnë format dhe përmasat e zdruktheve.
- Të shpjegojnë ndikimin e formës dhe përmasave të zdruktheve në cilësinë e pllakës prej zdrukthi.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës me disk thikëmbajtës për prodhimin e zdrukthit të sheshtë.

- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën me disk thikëmbajtës për prodhimin e zdrukthit të sheshtë.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës për copëzimin e zdrukthit.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën për copëzimin e zdrukthit.
- Të shpjegojnë rëndësinë dhe kushtet e tharjes së zdruktheve.
- Të lexojnë skemën e punës së makinës për tharjen e zdruktheve.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën për tharjen e zdruktheve.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës për seleksionimin e zdruktheve.
- Të shpjegojnë mënyrën e punimit të makinës për seleksionimin e zdruktheve.
- Të dallojnë recetat e përgatitjes së lëndës ngjithëse për lyerjen e zdruktheve të shtesave të ndryshme
- Të lexojnë skemën e punës të makinës për lyerjen e zdruktheve.
- Të shpjegojnë mënyrën e punimit të makinës për lyerjen e zdruktheve
- Të përshkruajnë procesin e formimit të qilimit me zdrukthe.
- Të lexojnë skemën e punës të makinave të formimit të qilimit me zdrukthe.
- Të shpjegojnë mënyrën e punimit të makinave të formimit të qilimit me zdrukthe.
- Të shpjegojnë rëndësinë e procesit të presimit të pllakës me zdrukthe.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës presë.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinat presë.
- Të dallojnë parametrat e regjimit të presimit të kompensatës dhe faktorët që ndikojnë në to.
- Të dallojnë veçoritë e proceseve përfundimtare të prodhimit të pllakës të zdrukthit.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të pllakës të fibrës, vendosjen e makinave sipas operacioneve të punës.
- Të shpjegojnë mënyrën e përgatitjes dhe përpunimit të lëndës të parë.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të copëtimit të drurit në ashkla që do defibrohen.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e copëtimit të drurit në ashkla që do defibrohen.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të seleksionimit dhe mënyrën e punimit në të.
- Të përshkruajnë pajisjen e transportimit dhe depozitimit të ashklave në fabrikën e pllakës të fibrës.
- Të dallojnë kushtet e trajtimit paraprak dhe defibrimit të ashklave
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të defibrimit të drurit dhe mënyrën e punimit në të.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e defibrimit të drurit.
- Të dallojnë pjesët e agregatit të defibrimit.
- Të dallojnë procesin e rafinimit nga defibrimi.
- Të shpjegojnë rëndësinë e shpëlarjes dhe filtrimit të masës të fibrave dhe pajisjen që përdoret.
- Të dallojnë kimikatet që përdoren për pllakën e fibrës si lënda ngjithëse, hidrofuge, forcues, si dhe recetat e përgatitjes të tyre.
- Të shpjegojnë mënyrën e bashkimit të fibrave me kimikate dhe pajisjen përkatëse.
- Të rendisin makinat e formimit të qilimit me fibra dhe të dallojnë veçoritë e tyre.
- Të përshkruajnë sektorët e makinës të formimit.
- Të dallojnë veçoritë e secilit sektor.

- Të shpjegojnë rëndësinë e procesit të presimit të pllakës të fibrës.
- Të dallojnë veçoritë e ndërtimit të plitës në presat për pllakë fibre me metodën e njomë.
- Të dallojnë parametrat e regjimit të presimit të pllakës të fibrës dhe faktorët që ndikojnë në to.
- Të shpjegojnë rëndësinë e trajtimit termik të pllakës të fibrës, kushtet e kryerjes dhe paisjet.
- Të dallojnë veçoritë e proceseve përfundimtare të prodhimit të pllakës të fibrës.
- Të shpjegojnë veçoritë e teknologjisë së procesit të prodhimit të pllakës të fibrës të butë ose izoluese.
- Të shpjegojnë veçoritë e teknologjisë të procesit të thatë të prodhimit të pllakës të fibrës dhe M.D.F.
- Të shpjegojnë veçoritë e teknologjisë të procesit gjysmë të njomë të prodhimit të pllakës të fibrës.
- Të shpjegojnë veçoritë e teknologjisë të procesit të prodhimit të pllakës të fibrës pa lëndë ngjitëse.
- Të përshkruajnë përdorimin e pllakës panel.
- Të shpjegojnë ndërtimin e pllakës panel.
- Të përshkruajnë veçoritë e lëndës të parë që përdoret për pllakën panel.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të pllakës panel në mënyrë artizanale.
- Të shpjegojnë ngjitjen dhe presimin e pllakave panel.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të pllakave panel në linja.
- Të shpjegojnë veçoritë e prodhimit të pllakave panel me ngjitje.
- Të përshkruajnë procesin e sharrimit të blloqeve të pllakave panel.
- Të përshkruajnë teknologjinë e prodhimit të pllakës qelizore.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të formatizimit të pllakave.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e formatizimit të pllakave
- Të lexojnë skemën e punës të makinës së kalibrimit.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e kalibrimit.
- Të përshkruajnë mënyrën e përpunimit të sipërfaqes dhe brinjëve të pllakave për përmirësimin e pamjes duke e veshur me rimeso, shtresë filmi të imituar, patinim etj.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e makinave të patinimit.
- Të shpjegojnë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve dhe makinave të imitimit.
- Të lexojnë skemën e punës të makinës të shpimit me shumë punto.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën e shpimit me shumë punto.
- Të lexojnë skemën e punës së makinës frezë kopjuese.
- Të shpjegojnë përgatitjen për punë dhe mënyrën e punimit në makinën frezë kopjuese.

• **Përmbajtjet e përgjithshme të lëndës "Teknologjia e prodhimeve gjysmë të gatshme me mbetje druri" kl. 12- 68 orë:**

Tema 1	Teknologjia e prodhimit të pllakave prej zdrukthi.	2 orë
Tema 2	Përgatitja dhe përpunimi i lëndës së parë	4 orë
Tema 3	Prodhimi i ashklave, zdrukthit dhe depozitimi i tij	6 orë
Tema 4	Tharja dhe lyerja e zdrukthit	4 orë
Tema 5	Formimi i qilimit të pllakës prej zdukthi	4 orë
Tema 6	Presimi i pllakës prej zdrukthi	4 orë

Tema 7	Teknologjia e prodhimit të pllakës së fibrës	2 orë
Tema 8	Përgatja e lëndës së parë, copëtimi i drurit .	4 orë
Tema 9	Defibrimi i ashklave, përpunimi i fibrave me kimikate	7 orë
Tema 10	Formimi i qilimit me fibra	4 orë
Tema 11	Presimi dhe trajtimi termik.	5 orë
Tema 12	Mënyra të tjera të fabrikimit të pllakës së fibrës, M.D.F.	4 orë
Tema 13	Teknologjia e prodhimit të pllakës panel	6 orë
Tema 14	Teknologjia e prodhimit të pllakës qelizore	4 orë
Tema 15	Përpunimi përfundimtar i pllakave, makinat	8 orë

IX.Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale të detyruar

1.Moduli: “Punime për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatshme.”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME PËR DEPOZITIMIN DHE TRAJTIMIN E LËNDËS SE PARE PËR PRODHIME DRURI GJYSMË TË GATSHME	(M-04-1450-18)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer procese pune, për depozitimin dhe trajtimin e lëndës drunore për prodhime druri gjysmë të gatshme.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i sheshit të depozitës– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i radhës së punës.– Zgjedhja e lëndës të parë që depozitohet në shesh.– Zgjedhja e mjeteve matëse, shenuese dhe kontrolluese.– Zgjedhja e metodës së ruajtjes së trupave– Zgjedhja e mënyrës së trajtimit të lëndës së parë– Zgjedhja e paisjeve, makinave prerëse të nevojshme– Zgjedhja e mjeteve ngarkuese dhe transportuese .– Zgjedhja e mjeteve matëse, shenuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerëse ,mjeteve matëse, shenuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit	

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të skicojë sipërfaqen sheshit të depozitës.
- të analizojë dhe interpretojë vizatime mbi organizimin e sheshit të depozitës së trupave për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë.
- të përshkruajë saktë radhën e punimeve.
- të zgjedhë lëndën e parë trupa për lëndë të sharruar, trupa për rimeso dhe kompensatë.
- të zgjedhë metodën e ruajtjes së trupave.
- të zgjedhë mënyrën e trajtimit hidrotermik të trupave.
- të zgjedhë paisjen, makinën prerëse të nevojshme.
- të zgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese.
- të zgjedhë mjetet ngarkuese dhe transportuese të nevojshme.
- të vendosë me kujdes në depozite sipas përmasave, trupa për lëndë të sharruar, trupa për rimeso dhe kompensatë.
- të organizojë vendin e punës sipas rregullave.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për depozitimin dhe trajtimin paraprak të materialit drunor për prodhime druri gjysmë të gatëshme.

RM 2 Nxënësi kryen procese pune për depozitimin e trupave, për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë**Përmbajtja:**

- Kontrolli i sheshit të depozites sipas skicës.
- Marrja në dorëzim e trungjeve, trupave.
- Kontrolli i trupave në përputhje me kushtet teknike.
- Ndarja e trupave për rezervë dimërore.
- Matja e trupave.
- Ndarja e trupave në grupe diametrikë.
- Ndarja e trupave për rimeso nga ato për kompensatë.
- Dërgimi i trupave të rimesos për tu prerë në pllaka.
- Llogaritja e vëllimit.
- Vendosje e tabelave në stiva.
- Llogaritja e sipërfaqes së depozitës.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punës për depozitimin dhe trajtimin paraprak të materialit drunor për prodhime druri gjysmë të gatëshme.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë sheshin e depozitës sipas skicës, në ndërtim, në pastërti, për pajisjet e nevojshme, ngarkuese dhe shkarkuese.
- të marrë në dorëzim trupat duke kontrolluar kohën e prerjes.
- të kontrollojë trupat në përputhje me kushtet teknike.
- të ndajë trupat për rezervë dimërore duke patur parasysh sasinë e trupave, mekanizmat që përdoren dhe kushtet e terrenit.
- të masë përmasat e trupave, diametrin me kalibër sipas rregullave si dhe gjatësinë e tyre.
- të ndajë trupat në grupe diametrikë në rast se priten në gatër.
- të llogarisë vëllimin e trupave duke zbritur kalbëzimin e brendshëm në rast se ka dhe lëvoren te fletorët.
- të ndajë trupat për rimeso nga ato për kompensatë.
- të dërgojë trupat për rimeso për tu prerë në pllaka.
- të vendosë tabelat në stiva me grupin diametrik, gjatësinë llojin e drurit.
- të llogaritë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh sipërfaqen e skelës të shkarkimit, rezervës dimërore, trupave të ndarë në grupe diametrikë, sipërfaqe me stiva të trupave që nuk punohen dhe sipërfaqe me rrugë komunikimi dhe hapësira ajrimi;
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune, për depozitim të trupave për lëndë të sharruar, kompensatë dhe rimeso;

RM 3 Nxënësi kryen procese pune për trajtimin paraprak të trupave për lëndë të sharruar , rimeso dhe kompensatë.

Përmbajtja

- Zgjedhja e metodës së ruajtjes së trupave
- Përcaktimi i rregjimit gjatë ruajtjes së trupave
- Ndjekja e rregjimit të punës, sipas metodës së ruajtjes
- Dërgimi i trupave të rimesos për tu prerë në pllaka.
- Zgjedhja e metodës së trajtimit hidrotermik i trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Përcaktimi i rregjimit të trajtimit termik të trupave
- Ndjekja e trajtimit termik të trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Shkurtimi i trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune për trajtimin paraprak të trupave për prodhimin e lëndës së sharruar, rimesos dhe kompensatës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të zgjedhë metodën e ruajtjes së trupave për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë, në basena, me shi artificial apo metodë kimike.
- të përcaktojë parametrat e rregjimit të ruajtjes së trupave sipas metodës së zgjedhur.
- të kryejë procese pune për ndjekjen e rregjimit në basenat e ruajtjes apo te njomja me shi artificial etj.
- të dërgojë trupat e rimesos për tu prerë në pllaka në makinën gatër horizontal.
- të zgjedhë metodën e trajtimit hidrotermik të trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- të përcaktojë parametrat e rregjimit të trajtimit termik sipas faktorëve që ndikojnë në të.
- të kryejë procese pune për realizimin e trajtimit termik të trupave dhe pllakave për rimeso, në basenat e trajtimit termik, duke ndjekur me përpikmëri parametrat e rregjimit.
- të kryejë procese pune për shkurtimin në koka, në sharrën ballancë, trupat dhe pllakat e trajtuara termikisht.
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune, për trajtimin e trupave për lëndë të sharruar, për rimeso dhe kompensatë.

RM 4 Nxënësi kryen procese pune për depozitimin e lëndës drunore për pllakë zdrukthit dhe fibre

Përmbajtja:

- Kontrolli i sheshit të depozitës sipas skicës.
- Marja në dorëzim e lëndës të parë mbetje druri.
- Ndarja e mbetjeve sipas asortimentit.
- Kontrolli i asortimenteve të lëndës të parë në përputhje me kushtet teknike.
- Ndarja e lëndës rezervë.
- Matja e asortimenteve të lëndës të parë për pllakë zdrukthi .
- Stivimi i lëndës të parë sipas asortimenteve.
- Vendosija e tabelave treguese në cdo stivë.
- Llogaritja e sipërfaqes të depozitës.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit, në procese pune, gjatë depozitimit të lëndës së parë për pllakë zdrukthit , fibre.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për mbarvajtjen e sheshit të depozites sipas skicës, në ndërtim, në pastërti, për disinfektim, për pajisjet e nevojshme ngarkuesedhe shkarkuese.
- të kryejë procese pune të marrjes në dorëzim të lëndës së parë si mbetje druri.
- të kryejë procese pune në ndarjen e mbetjeve sipas asortimentit.
- të kontrollojë asortimentet e lëndës së parë në përputhje me kushtet teknike.
- të kryejë procese pune në ndarjen e lëndës rezervë.
- të kryejë procese pune në matjen e asortimenteve të lëndës së parë për pllakë zdrukthi, fibre.
- të kryejë procese pune në stivimin e lëndës së parë sipas asortimenteve.
- të kryejë procese pune në vendosjen e tabelve treguese në cdo stivë.
- të llogarisë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh sipërfaqen e skelës së shkarkimit, rezervës së caktuar në rast remonti të fabrikës, sipërfaqe me stiva të asortimenteve të ndryshme dhe sipërfaqe me rrugë komunikimi dhe hapësira ajrimi.
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitimin e lëndës të parë për prodhimin e pllakës të zdrukthit, fibrës;

RM 5 Nxënësi kryen procese pune për trajtimin e lëndës drunore për pllakë zdrukthi dhe fibre.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i rregjimit gjatë ruajtjes së trupave.
- Ndjekja e rregjimit të punës, sipas metodës së ruajtjes.
- Dërgimi i trupave të rimesos për tu prerë në pllaka.
- Zgjedhja e metodës së trajtimit hidrotermik i trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Përcaktimi i rregjimit të trajtimit termik të trupave.
- Ndjekja e trajtimi termik i trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Shkurtimi i trupave dhe pllakave për rimeso dekorative.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune për trajtimin paraprak të trupave për lëndë të sharruar, rimeso dhe kompensatë.
- Shkurtimi i lëndës së parë.
- Zgjedhja e metodës për njomjen e materialit.
- Përcaktimi i rregjimit gjatë njomjes të materialit drunor (mbetje).
- Njomja e materialit me ujë.

- Zgjedhja e metodës për trajtimin hidrotermik të lëndës së parë.
- Trajtimi hidrotermik i lëndës të parë.
- Heqja e lëvores para copëtimit.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës të parë të të prodhimit të pllakës të zdrukthit, të fibrës.

Instrumentet e vlerësimit

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për shkurtimin e lëndës së parë si anie listela degë voza etj sipas kërkesave;
- të përcaktojë metodën e përshtatëshme për njomjen e materialit drunor;
- të kryejë procese pune për njomjen e materialit drunor me ujë deri në 40% ;
- të zgjedhë metodën për trajtimin hidrotermik të lëndës së parë
- të kryejë procese pune për trajtimin termik të lëndës të parë, në se është i nevojshëm;
- të kryejë procese pune në heqjen e lëvores, në se e lejon standarti;
- të llogarisë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh sipërfaqen e skelës të shkarkimit, rezervës të caktuar në rast remonti të fabrikës, sipërfaqe me stiva të asortimenteve të ndryshme dhe sipërfaqe me rrugë komunikimi dhe hapësira.
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune për trajtimin paraprak të lëndës së parë për pllakë zdrukthi, fibre;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikant. Profesionale të përpunim drurit, në punishte, fabrika të prodhimeve druri gjysmë të gatëshme.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatëshme.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, të proceseve të punës për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatëshme
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatëshme.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i

shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e proceseve të punës, për depozitimin dhe trajtimin e lëndës së parë për prodhime druri gjysmë të gatëshme

- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës, sheshe të depozitimit të lëndës të parë për prodhime druri gjysmë të gatëshme, basena për ruajtje, basena për trajtim termik, mjete për njomjen e lëndës Komploti i veglave mjete matëse kaliber, metër, aparat për matjen e lagështirës, mjete ngarkuese dhe transportuese, mjete për qërimin e lëvoreë, mjete për centrim të trupave, sharë ballancë
 - Skica të shesheve të depozitë të lëndës të parë të punishteve, fabrikave për prodhime druri gjysmë të gatëshme.
 - Lëndë e parë, trupa druri për lëndë të sharruar, trupa për rimeso dhe kompensatë, mbetje druri për pllakë zdrukthi, fibre.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

2. Moduli “Punime në makina të lëndës drunore

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme
Niveli: II
Klasa: 12

PËRSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME NË MAKINA TË LËNDËS DRUNORE	(M-09-1451-18)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer procese pune në makina me lëndën drunore, për prodhime gjysmë të gatshme prej druri.	
Kohezgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Organizimi i vëndit të punës.– Skicimi i modelit të prerjes.– Zbërthimi i skicës.– Përzgjedhja e lëndës drunore.– Përzgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për punime të lëndës drunore për prodhime gjysmë të gatshme prej druri.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit për punime të lëndës drunore për prodhime gjysmë të gatshme prej druri. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të organizojë vendin e punës, për punime të lëndës drunore për prodhime gjysmë të gatshme prej druri.– të skicojë modelin e prerjes të lëndës drunore, sipas kërkesës.– të zbërthejë skicën e modelit të prerjes sipas përdorimit, për lëndë të sharuar, për kompensatë, për zdrukthe, fibra etj.– të përzgjedhë lëndën drunore, trupa, degë voza, anie listela etj.– të zgjedhë veglat, pajisjet dhe makinat për prerjen e lëndës drunore si trupa, degë voza, anie listela etj.– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së	

mjedisit gjatë punimeve për përpunimin në makina të lëndës drunore, trupa, degë voza, anie listela etj.

RM 2 Nxënësi kryen punime në makinën gatër

Përmbajtja

- Përgatitja e modelit të prerjes.
- Përgatitja e gatrit për punë.
- Kontrolli i instrumentit prerës, lamës.
- Vendosja e lamave në gatër.
- Vendosja e modeleve.
- Vendosja e pykave.
- Kontrolli i pjerësisë të lamës.
- Kontrolli i pjerësisë të ramës.
- Shtrëngimi i regjistrave.
- Rregjistrimi i mekanizmit të avancit.
- Vendosja e trupave në vagonetë.
- Prerja e trupave
- Kontrolli i cilësisë të punimeve
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes të trupave në gatër.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për përgatitjen e modelit të prerjes sipas grupit diametrik të trupave që do priten.
- të kryejë procese pune për përgatitjen e gatrit për punë sipas metodës dhe modelit të prerjes;
- të kontrollojë karakteristikat e instrumentit prerës, lamës;
- të kryejë procese pune për vendosjen e lamave në ramë sipas modelit të prerjes;
- të kryejë procese pune për vendosjen e shablloneve ndërmjet lamave sipas trashësisë të dërrasës;
- të kryejë procese pune për vendosjen e pykave për shtrëngimin e lamave në ramë;
- të kryejë procese pune për kontrollin, me peplumb, të pjerësisë së lamës në ramë.
- të kryejë procese pune për kontrollin e pjerësisë së ramës në gatër.
- të kryejë procese pune për të shtrënguar garnityrën e lamave dhe shablloneve.
- të kryejë procese pune për rregjistrimin e mekanizmit të avancit sipas kërkesës;
- të kryejë procese pune për vendosjen e trupave në vagonetë, ose në transportier për të drejtuar drejt lamave të gatrit;
- të kryejë procese pune për prerjen e trupave në dërrasa;

- të kontrollojë cilësinë e punimit, të lëndës të sharruar sipas standartit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes të trupave në gatër;

RM 3 Nxënësi kryen punime në makinën sharrë

Përmbajtja

- Përgatitja e sharrës shirit, disk për punë.
- Kontrolli i instrumentit prerës, shiritit, diskut
- Vendosja e instrumentit në makinë.
- Shtrëngimi i instrumentit prerës.
- Regjistrimi i trashësisë të prerjes të dërrasës.
- Vendosja e trupave në vagonetë ose në transportier.
- Prerja e trupave.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes të trupave në makinat sharrë.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për përgatitjen e sharrës shirit, disk për punë, sipas skicës.
- të kontrollojë instrumentin prerës, shiritin, diskut për karakteristikat e tij të gatëshme për punë.
- të kryejë procese pune për vendosjen e shiritit, diskut dhe të realizojë, me kujdes, shtrëngimin e tij.
- të kryejë procese pune për regjistrimin e trashësisë së dërrasës me shabllon ose me pult komandimi.
- të kryejë procese pune për regjistrimin e mekanizmit të avancit sipas kërkesës.
- të kryejë procese pune për vendosjen dhe fiksimin, me mekanizmat përkatës, trupat në vagonetë ose në transportier për tu drejtuar drejt instrumentit prerës, të kryejë procese pune për prerjen, në makinë sharrë, të trupave në dërrasa.
- të kontrollojë cilësinë e punimit të dërrasave ose lëndës të sharruar sipas standartit.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes të trupave në makinat sharrë shirit, disk.

RM 4 Nxënësi kryen punime në makina torno

Përmbajtja

- Regjistrimi i makinës torno.
- Shkurtimi i trungut në gjatësinë e kërkuar

- Heqja e lëvores.
- Përcaktimi i qendrës së trungut.
- Fiksimi i trungut në shpindelat e tornos.
- Tornimi i trungut për të marrë rimeso.
- Kontrolli i fletëve të rimesos.
- Stivimi sipas cilësisë i fletëve të rimesos.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet dhe makina.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e rimesos dekorative.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- Të rregjistrojë makinën torno sipas trashësisë së rimesos ;
- të kryejë procese pune për shkurtimin e trungut në gjatësinë e kërkuar.
- të kryejë procese pune për heqjen e lëvores sipas kërkesës.
- të kryejë procese pune për përcaktimin e qendrës së trungut me mjetet përkatëse.
- të kryejë procese pune për të fiksuar trungun në shpindelat e tornos.
- të kryejë procese pune për tornimin e trungut për të marrë rimeso.
- të kontrollojë fletët e rimesos.
- të kryejë procese pune për stivimin sipas cilësisë të fletëve të rimesos.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e rimesos në torno.

RM 5 Nxënësi kryen punime në makina e copëtimit të drurit.

Përmbajtja

- Regjistrimi i makinës me disk thikëmbajtës horizontal ose vertikal.
- Matja e lëndës të parë.
- të kryejë procese pune për prerjen e lëndës të parë në gjatësinë e kërkuar.
- Furnizimi i makinës me lëndë të parë.
- Prodhimi i zdrukthit.
- Transportimi i zdrukthit nga makina në ciklon.
- Kontrolli i gjatësisë dhe gjërësisë të zdrukthit.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për prodhimin e zdrukthit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të bëjë regjistrimin e makinës me disk thikëmbajtës, horizontal ose vertikal, me cilindër thikëmbajtës.

- të masë lëndën e parë për ta përshtatur për dimensionet e gojës së makinës;
- të kryejë procese pune përjen e lëndës të parë në gjatësinë e kërkuar.
- të kryejë procese pune për furnizimin e makinës me lëndë të parë.
- të kryejë procese pune për prodhimin e zdrukthit në makinën e copëtimit me disk thikëmbajtës, horizontal ose vertikal, me cilindër thikëmbajtës ;
- të kontrollojë formën dhe përmasat e zdrukthit sipas standartit, mbasi dalin nga makina;
- të kujdeset për veglat dhe paisjet dhe makinat;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në mjediset për praktikat profesionale të përpunim drurit, në repartet e makinerisë të prodhimeve gjysmë të gatëshme prej druri.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të procedurave të prerjes së materialit drunor në makina gatër, sharë për trupa, torno, makina të copëtimit etj.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në matje dhe prerje, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prerjen e materialit drunor në makina gatër, sharë për trupa, torno, makina të copëtimit etj.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e prerjes materialit drunor në makina gatër, sharë për trupa, torno, makina të copëtimit etj.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për matjen dhe prerjen e materialit drunor në makina gatër, sharë për trupa, torno, makina të copëtimit etj.
 - Komplet i veglave, pajisjeve, makinave dhe materialeve të nevojshme për prerje të materialit drunor në makina gatër, sharë për trupa, torno, makina të copëtimit etj.
 - Lëndë e parë trupa binarë druri, anie, mbeturina rimeso etj..
 - Skica të ndryshme qqë i shërbejnë prerjes në makina.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

3. Moduli “Punime të lyerjes me lëndë ngjitëse dhe kimikate të tjera

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme.
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKUESII I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TË LYERJES ME LËNDË NGJITËSE DHE KIMIKATE TË TJERA	(M-09-1452-18)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime të lyerjes, të materialit drunor si rimeso, listela druri, ashkla ose zdrukthe, fibra druri me, lëndë ngjitëse, hidrofuge, fiksues etj.	
Kohezgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Përshtatja e vendit të punës.– Leximi i skemës të punës të makinave të lyerjes me lëndë ngjitëse.– Përzgjedhja e kimikateve për lyerje.– Përzgjedhja e materialeve drunore ku do aplikohen kimikatet si lënda ngjitëset, hidrofuge, fiksuese etj.– Zgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave të përzierjes dhe lyerjes të lëndës ngjitëse.– Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të lyerjes me kimikate, lëndë ngjitëse, hidrofuge, fiksues etj, të materialit drunor të punuar në makina si rimeso, ashkla ose zdrukthe, fibra etj. <p>Instrumentet e vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli.</p> <p>Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të organizojë vendin e punës për procese pune të lyerjes të fletëve të kompensatës, zdruktheve dhe fibrave prej druri me lëndë ngjitëse, hidrofuge, fiksues etj.– të lexojë skemën e punës të makinave të përgatitjes dhe dozimit, të lyerjes me lëndë ngjitëse, hidrofuge, fiksuese etj.– të zgjedhë kimikatet e nevojshme, lëndë ngjitëse, hidrofuge, fiksues etj, për lyerje.– të përzgjedhë materialet që do lyen me kimikate, lëndë	

ngjitëse, hidrofuge, fiksues si fletët e kompensatës, zdrukthe druri, fibra druri etj.

- të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për lyerjen e fletët të kompensatës, zdruktheve prej druri, fibra druri etj.
- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punë për lyerjen e fletëve të kompensatës, zdruktheve, fibrave prej druri etj.

RM 2 Nxënësi kryen punime të lyerjes me lëndë ngjitëse dhe kimikate të tjera në fletët e kompensatës

Përmbajtja

- Regjistrimi i makinës të lyerjes të fletëve të kompensatës
- Kontrolli i fletëve të kompensatës.
- Përgatitja e lëndës ngjitëse sipas recetës.
- Furnizimi i makinës me lëndë ngjitëse.
- Lyerja e fletëve të kompensatës.
- Kontrolli i cilësisë të lyerjes.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për lyerjen e fletëve të kompensatës me lëndë ngjitëse.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të rregjistrojë makinën e lyerjes me lëndë ngjitëse, për avancimin e fletës të kompensatës dhe për dozimin e lëndës ngjitëse sipas normativës;
- të kontrollojë, sipas kërkesës, fletët sipas cilësisë për mesore të kompensatës që do lyen me lëndë ngjitëse;
- të kryejë procese pune për përgatitjen e lëndës ngjitëse sipas recetës.
- të kryejë procese pune për furnizimin e makinës së lyerjes me lëndë ngjitëse sipas kërkesës.
- të kryejë procese pune për të lyer me lëndë ngjitëse fletët e kompensatës me sasinë e caktuar në normativë.
- të kontrollojë cilësinë e lyerjes me lëndë ngjitëse.
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës gjatë lyerjes.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për lyerjen e fletëve të kompensatës me lëndë ngjitëse.

RM 3 Nxënësi kryen punime për lyerjen me lëndë ngjitëse të zdruktheve, ashklave dhe fibrave

Përmbajtja

- Regjistrimi i dozuesit të zdruktheve dhe lëndës ngjitëse.
- Regjistrimi i makinës të lyerjes të zdruktheve prej druri.
- Regjistrimi i paisjes të përzierjes të masës të fibrave me kimikate.
- Kontrolli i përqendrimit të masës të fibrave druri.

- Kontrolli i parametrave të zdruktheve, ashklave dhe fibrave prej druri.
- Përgatitja e lëndës ngjitëse sipas recetës.
- Furnizimi i makinës me lëndë ngjitëse.
- Lyerja e zdruktheve prej druri.
- Furnizimi i paisjes të përzierjes të masës të fibrave me kimikate.
- Kontrolli i cilësisë të lyerjes.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për lyerjen e ashklave, zdruktheve, fibrave prej druri me lëndë ngjitëse dhe kimikate të tjera.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të regjistrojë vartësinë e dozuesit të lëndës ngjitëse me dozuesin e zdruktheve, sipas normatives, për në makinën e lyerjes.
- të rregjistrojë makinën e lyerjes me lëndë ngjitëse për avancimin e zdruktheve në të dhe për lyerjen e zdruktheve me sasinë e lëndës ngjitëse sipas normativës.
- të kontrollojë zdrukthet drunore, për lagështinë para lyerjes, sipas standartit.
- të regjistrojë pajisjen dozuese për kimikatet, sipas kërkesës dhe përqëndrimin të caktuar, lëndën ngjitëse, kollofon, sulfat alumini etj.
- të rregjistrojë paisjen e përzierjes të masës të fibrave me kimikate.
- të kontrollojë përqëndrimin e masës të fibrave sipas kërkesës.
- të përgatisë lëndën ngjitëse, hidrofuge, forcues kimikate të tjera dhe përzierja e tyre sipas recetës;
- të furnizojë makinën me lëndë ngjitëse të përgatitur me kimikate të tjera sipas recetës;
- të kryejë procese pune të lyerjes së zdruktheve, ashklave dhe fibrave sipas normativës me lëndë ngjitëse;
- të kontrollojë cilësinë e lyerjes për zdrukthet, ashklat, fibrat sipas kërkesës;
- të kujdeset për veglat, pajisjet e punës dhe makinat;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për lyerjen e zdruktheve ashklave dhe fibrave prej druri me lëndë ngjitëse.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e lyerjes me lëndë ngjitëse të materialit drunor, rimeso, zdrukthe dhe fibra.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve pune të lyerjes të kompensatës, të zdruktheve prej druri dhe të

masës të fibrave drunore në makinat e lyerjes, të organizojë edhe vizita në fabrika apo punishte ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për lyerjen e fletëve të kompensatës, zdruktheve dhe fibra prej druri.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për lyerjen e fletëve të kompensatës, të zdruktheve dhe masës të fibrës drunore, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për lyerjen e fletëve të kompensatës të zdruktheve dhe masës të fibrave drunore;
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të lyerjes të fletëve të kompensatës, të zdruktheve dhe masës të fibrave drunore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për punime të prodhimit të zdruktheve dhe fibrave.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të prodhimit të zdruktheve dhe fibrave prej druri.
 - Instrumenta prerëse, të makinave me disk thikëmbajtës, cilindër thikëmbajtës, mulli thërmues, defibrator.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Mbetje të ndryshme druri, degë, anie, listela etj si dhe materiale ndihmëse për prodhim.
 - Skica e formës të zdruktheve, skema të punës të makinave të prodhimit të zdrukthit dhe diqeve defibrues.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

4. Moduli “Punime të ngjitjes të materialit drunor për pllaka ”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme.
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKUESII I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME TE NGJITJES TE MATERIALIT DRUNOR PER PLLAKA	(M-09-1453-18)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer procese pune në presa hidraulike për presimin e pllakave si kompensatë, pllakë zdrukthi, pllakëfibre, M.D.F.etj.	
Kohezgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e të mesuarit (RM), Përbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përshtatja e vendit të punës.– Skicimi i plitës të presës– Lezimi i skemës të punës të presës hidraulike.– Përzgjedhja e pllakave që do presohen.– Zgjedhja e veglave, pajisjeve dhe presës hidraulike.– Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës në presa hidraulike. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të organizojë vendin e punës për procese pune në presa hidraulike të presimit të prodhimeve gjysmë të gatshme si kompensatë pllakë zdrukthi, pllakë fibre, M.D.F.– të skicojë skemën e plitës të presës.– të lexojë skemën e punës të presës hidraulike.– të përzgjedhë pllakat që do presohen.– të përgatisë veglat, pajisjet dhe presat hidraulike.– të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës në presën hidraulike. RM 2 Nxënësi kryen punime presimi në presa për kompensatën Përbajtja <ul style="list-style-type: none">– Regjistrimi i presës hidraulike.– Kontrolli i aparateve për matjen e rregjimit në presë.	

- Kontrolli i paketës me fletët e kompensatës.
- Furnizimi i kateve të presës me paketa kompesate.
- Mbyllja e presës.
- Ndjekja e rregjimit të presimit.
- Hapja e presës.
- Shkarkimi i presës.
- Kontrolli i cilësisë të presimit.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve per presimin e paketës me fletë kompesate.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të rregjistrojë presën hidraulike, për presimin e paketës me fletë kompesate;
- të kontrollojë plitat, ashensorët ngarkues dhe shkarkues, mekanizmin hidraulik, paisjet e avullit etj.
- të kontrollojë aparatet për matjen e parametrave të rregjimit në presë si presionin, temperaturën dhe kohën.
- të kontrollojë paketën e kompensatës të formuar sipas standartit.
- Të furnizojë presën me paketa kompesate duke vënë në lëvizje ashensorin ngarkues të saj.
- të realizojë, në kohën e caktuar, mbylljen e presës.
- të ndjekë parametrat e rregjimit të presimit, të përcaktuara në funksion të lloit të drurit, trashësisë të rimesos etj.
- të realizojë hapjen e presës në mbarim të kohës të rregjimit të përcaktuar.
- të shkarkojë presën me ndihmën e ashensorit shkarkues;
- të kontrollojë cilësinë e presimit të fletëve të kompesatës sipas standartit.
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve per presimin e fletëve të kompesatës.

RM3 Nxënësi kryen punime presimi në presa për pllakë zdrukthi

Përmbajtja

- Regjistrimi i presës hidraulike.
- Kontrolli i aparateve për matjen e rregjimit në presë.
- Kontrolli i qilimit me zdrukthe.
- Furnizimi i kateve të presës me formate të qilimit me zdrukthe druri.
- Mbyllja e presës.
- Ndjekja e rregjimit të presimit.
- Hapja e presës.

- Shkarkimi i presës
- Kontrolli i cilësisë të presimit.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për presimin e formateve të qilimit me zdrukthe druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të rregjistrojë presën hidraulike, për presimin e fletëve të kompensatë.
- të kontrollojë plitat, ashensorët ngarkues dhe shkarkues, mekanizmin hidraulik, paisjet e avullit etj.
- të kontrollojë aparatet për matjen e parametrave të rregjimit në presë si presionin, temperaturën dhe kohën.
- të kontrollojë qilimin me zdrukthe të formuar dhe formatuar sipas standartit.
- të furnizojë presën më formate të qilimit me zdrukthe druri.
- të realizojë, në kohën e caktuar, mbylljen e presës.
- të ndjekë parametrat e rregjimit të presimit, të përcaktuara në funksion të karakteristikave të pllakës së zdukthit.
- të realizojë hapjen e presës në mbarim të kohës së rregjimit të përcaktuar.
- të shkarkojë presën me ndihmën e ashensorit shkarkues.
- të kontrollojë cilësinë e presimit të pllakës së zdukthit.
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për presimin e pllakës së zdukthit.

RM 4 Nxënësi kryen punime presimi në presa për pllakë fibre MDF

Përmbajtja

- Regjistrimi i presës hidraulike.
- Kontrolli i aparateve për matjen e rregjimit në presë.
- Kontrolli i qilimit me fibra.
- Furnizimi i kateve të presës me formate të qilimit me fibra druri.
- Mbyllja e presës.
- Ndjekja e rregjimit të presimit.
- Hapja e presës.
- Shkarkimi i presës.
- Kontrolli i cilësisë të presimit.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për presimin e qilimit me fibra druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

- të rregjistrojë presën hidraulike, për presimin e formateve të prera të qilimit me fibra druri.
- të kontrollojë plitat për vecoritë e ndërtimit të tyre, ashensorët ngarkues dhe shkarkues, mekanizmin hidraulik, paisjet e avullit etj.
- të kontrollojë aparatet për matjen e parametrave të rregjimit në presë si presionin, temperaturën dhe kohën.
- të kontrollojë qilimin me fibra të formuar dhe formatuar sipas standartit;
- të furnizojë presën më formate të qilimit me fibra druri.
- të realizojë në kohën e caktuar, mbylljen e presës.
- të ndjekë parametrat e rregjimit të presimit, të përcaktuara në funksion të karakteristikave të pllakës të fibrës.
- të realizojë hapjen e presës në mbarim të kohës së rregjimit të përcaktuar.
- të shkarkojë presën me ndihmën e ashensorit shkarkues.
- të kontrollojë cilësinë e presimit të pllakës të fibrës prej druri.
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për presimin e pllakës të fibrës prej druri.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të kompensatës, pllakave të zdrukthit dhe fibrës drunore në sektorin e presimit.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve pune të presimit të kompensatës, pllakës të zdrukthit dhe të fibres drunore në presa hidraulike, të organizojë edhe vizita në fabrika apo punishte ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për presimin e kompensatës, formateve të qilimit me zdrukthe dhe fibra druri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në presa për presimin e kompensatës, pllakave të zdrukthit dhe pllakave të fibrës drunore, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për presimin e kompensatës, pllakave të zdrukthit dhe pllakave të fibrës drunore.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës të presimit të kompensatës, pllakave të zdrukthit dhe pllakave të fibrës drunore.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

**Kushtet e
e domosdoshme
për realizimin e
modulit**

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për punime të prodhimit të kompensatës, pllakave të zdrukthit dhe fibrave drunore.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të presimit të kompensatës, të qilimit me zdrukthe dhe fibra druri.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Paketa kompesate, formate të qilimit me zdrukthe dhe ashkla druri dhe materiale ndihmëse për prodhim.
 - Skica e skemës së punës e presës hidraulike dhe të vecorive të plitave për pllakë fibre drunore.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

5. Moduli “Punime për prodhimin e lëndës të sharruar”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme.
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKUESII I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME PËR PRODHIMIN E LËNDËS TË SHARRUAR	(M-09-1454-18)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit në kryerjen e punime për të prodhuar lëndë të sharruar.	
Kohezgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punime për të përgatitur vendin e punës Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i planimetrisë, vendosjes së makinave sipas rradhës së punës.– Skicimi i modelit të prerjes– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i radhës së punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zgjedhja e lëndës të parë(trupa druri).– Zgjedhja e paisjeve,makinave prerëse të nevojshme– Zgjedhja e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.– Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerese ,mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes të mjedisit në punime për lëndë të sharruar. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– të skicojë planimetrinë, vendosjen e makinave për prodhimin e lëndës të sharruar, me të gjitha proceset, sipas rradhës.– të skicojë modelin e prerjes sipas kërkesës.– Të analizojë vizatimet e planimetrisë, vendosjen e makinave për prodhimin e lëndës të sharruar, me të gjitha proceset, sipas rradhës, skica të modeleve të prerjes, të pozicionit të rrathëve vjetorë ndaj faqes të jashtme të dërrasës etj.	

- të përcaktojë radhën e punës që nga skela e shkarkimit deri te depozita e lëndës të sharruar.
- të organizojë vendin e punës, sipas kërkesave, në të gjitha pjesët e procesit teknologjik të prodhimit të lëndës të sharruar.
- të zgjedhë lëndën e parë,(trupa druri) për në depozitë, për tu sharruar në makinat kryesore, dërrasë, për tu skuadruar në sharra cirkulare, ose për tu ndarë e sistemuar në depozitën e lëndës të sharruar sipas kërkesës.
- të zgjedhë paisjet, makinat prerëse të nevojshme si për përgatitjen e trupave në depozitë dhe për sharrimin e tyre, për përpunimin e dërrasave.
- të zgjedhë mjetet ngarkuese dhe transportuese, sipas kërkesës, për të lëvizur trupat, dërrasat në të gjitha proceset.
- të zgjedhë mjetet matëse, shenuese dhe kontrolluese.
- Të dërgojë materialet, pajisjet prerëse, mjeteve matëse, shenuese dhe kontrolluese në vendin e punës;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes të mjedisit në fabrikën e lëndës të sharruar;

RM 2 Nxënësi kryen punime në depozitën e trupave për prodhimin e lëndës së sharruar.

Përmbajtja

- Kontrolli i sheshit të depozites sipas skicës.
- Marja në dorëzim e trungjeve, trupave.
- Kontrolli i trupave në përputhje me kushtet teknike
- Ndarja e trupave për rezervë dimërore
- Vendosja e trupave në bazenat e ruajtjes dhe ndjekja e rregjimit të punës
- Matja e trupave.
- Ndarja e trupave në grupe diametrikë
- Llogaritja e vëllimit.
- Vendosje e tabelave në stiva.
- Llogaritja e sipërfaqes të depozitës.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune ne depozitën e trupave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kryejë prkontrollojë sheshin e depozites sipas skicës dhe për paisjet e nevojshme në të;
- të marrë në dorëzim trungjet, trupat duke kontrolluar kohën e prerjes;
- të kontrollojë trupat për verifikimin e kërkesave teknike në përputhje me kushtet teknike;

- të kryejë procese pune për të ndarë trupat për rezervë dimërore duke patur parasysh sasinë e trupave, mekanizmat që përdoren dhe kushtet e terreni;
- të kryejë procese pune për të vendosur trupat në bazenat e ruajtjes duke ndjekur rregullat e vendosjes të tyre dhe të ndrimit të ujit;
- të matë trupat në diametër me kalibër sipas rregullave si dhe gjatësinë e tyre;
- të kryejë procese pune për të ndarë trupat në grupe diametrikë në rast se priten në gater;
- të llogaritë vëllimin e trupave duke zbritur kalbëzimin e brëndshëm në rast se ka dhe levoren te fletorët sipas standartit.
- të vendosë tabelat në stiva me grupin diametrik gjatësinë lloin e drurit;
- të llogaritë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh sipërfaqen e skelës të shkarkimit, rezervës dimërore, e trupave të ndarë në grupe diametrikë, sipërfaqe me stiva të trupave që nuk punohen dhe sipërfaqe me rrugë komunikimi dhe hapësira ajrimi.
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune, në depozitën e trupave.

RM3 Nxënësi kryen punime sharrimi të trupave makinën gater, sharrë shirit, disk.

Përmbajtja

- Përgatitja e modelit të prerjes.
- Përgatitja e makinës për punë.
- Kontrolli i instrumentit prerës.
- Vendosja e instrumentit në makinë.
- Vendosja e shablloneve.
- Vendosja e pykave.
- Kontrolli i pjerësisë të lamës.
- Kontrolli i pjerësisë të ramës.
- Shtrëngimi i regjistrave.
- Shtrëngimi i shiritit.
- Rregjistrimi i trashësinë të prerjes të dërrasës.
- Rregjistrimi i mekanizmit të avancit.
- Vendosja e trupave në vagonetë .
- Prerja e trupave
- Kujdesi për vegla dhe pajisjet e punës.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune të sharrimit të trupave në makinën gater, sharrë shirit, disk.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë modelin e prerjes sipas grupit diamëtrik të trupave që do priten në makinën gatër;
- të përgatitë makinën e sharrimit për punë sipas metodës dhe modelit të prerjes;
- të kontrollojë instrumentin prerës, lamën e gatrit, shiritin, diskut për karakteristikat e tyre të gatëshme për punë;
- të vendosë lamat në ramën e gatrit sipas modelit të prerjes;
- të vendosë shabllonet ndërmjet lamave të gatëit sipas trashësisë të dërrasës;
- të vendosë pykat për shtrëngimin e lamave në ramën e gatërit;
- të kontrollojë, me peplumb, pjerësinë e lamës në ramë;
- të kontrollojë pjerësinë e ramës në gatër;
- të afrojë pjastrat për të shtrënguar garnytyrën e lamave dhe shabllonet;
- të vendosë shiritin dhe të realizojë, me kujdes, shtrëngimin e tij;
- të regjistrojë trashësinë e dërrasës me shabllon ose me pult komandimi;
- të regjistrojë mekanizmin e avancit sipas kërkesës;
- të vendosë trupat në vagonetë, ose në transportier për ti drejtuar drejt instrumentit prerës;
- të presë trupat në dërrasa sipas standartit;
- të kontrollojë cilësinë e punimit të dërrasave ose lëndës të sharruar sipas standartit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes të trupave në makinat gatër, sharrë shirit, sharrë disk për prerje trupash;

RM4 Nxënësi kryen punime sharrimi për aniet, binarët, prizmat në makinën sharrë shirit.

Përmbajtja

- Matja e trarëve, binarëve, prizmave etj.
- Përgatitja e modelit të prerjes.
- Përgatitja e makinës për punë.
- Kontrolli i instrumentit prerës.
- Vendosja e instrumentit në makinë.
- Shtrëngimi i shiritit.
- Rregjistrimi i trashësinë të prerjes të dërrasës.
- Rregjistrimi i mekanizmit të avancit.
- Vendosja e trarëve, binarëve etj. në mekanizmin e avancit.
- Prerja e trarëve, binarëve etj.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.

- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune të sharrimit të trarëve, binarëve etj. në makinën sharrë shirit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë aniet, prizmat, çerek trupash, binarëdhe trarë që dalin nga prerja e parë;
- të përgatitë modelin e prerjes sipas trashësisë të dërrasës.
- të përgatitë makinën e sharrimit për punë sipas modelit të prerjes.
- të kontrollojë instrumentin prerës apo shiritin për karakteristikat e tyre në mënyrë që të jenë të gatëshme për punë.
- të vendosë shiritin dhe të realizojë me kujdes shtrëngimin e tij.
- të regjistrojë trashësinë e dërrasës me shabllon ose me pult komandimi.
- të vendosë prizmat, çerek trupash, binarëdhe trarë që dalin nga prerja e parë në vagonetë, ose në transportier për ti drejtuar drejt instrumentit prerës të sharrës shirit për sharim;
- të kryejë procese pune për të prerë prizma, çerek trupa, binarë dhe trarë, që dalin nga prerja e parë, në dërrasa sipas standartit;
- të kontrollojë cilësinë e punimit të dërrasave ose lëndës të sharruar sipas standartit;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë prerjes së prizmave, çerek trupash, binarë dhe trarë, që dalin nga prerja e parë, në dërrasa sipas standartit;

RM 5 Nxënësi kryen punime sharrimi në gjatësi dhe skuadron dërrasat në makina sharrë rrethore.

Përmbajtja

- Përgatitja e sharrës rrethore për punë.
- Kontrolli i instrumentit prerës, diskut.
- Vendosja e instrumentit në makinë.
- Shtrëngimi i diskut.
- Rregjistrimi i gjerësisë apo gjatësisë të dërrasës.
- Sharrimi ose skuadrimi i dërrasës.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës të sharruar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë sharrën rrethore për punë sipas gjerësisë dhe gjatësisë të dërrasës të caktuara në standart;
- të kontrollojë instrumentin prerës, për karakteristikat e tij të gatëshme për punë;
- të vendosë instrumentin, po të jetë e nevojshme dy ose më shumë, të realizojë me kujdes shtrëngimin e tij.
- të kryejë procese pune për të regjistruar gjerësinë dhe gjatësinë e dërrasës sipas standartit me shabllon ose me pult komandimi.
- të kryejë procese pune për të sharruar dërrasën në gjatësi, të skuadrojë dërrasë në përmasa sipas standartit.
- të kontrollojë cilësinë e punimit të dërrasave sipas standartit.
- të kujdeset për vegla dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e mbrojtjes në punë dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë sharrimit të dërrasave në gjatësi dhe skuadrim në punishten/fabrikën e lëndës të sharruar.

RM6 Nxënësi kryen punime në depozitën e lëndës së sharruar (dërrasave).

Përmbajtja

- Kontrolli i sheshit të depozites sipas skicës
- Marja në dorëzim e lëndës së sharruar.
- Kontrolli i lëndës së sharruar në përputhje me standartin.
- Ndarja e lëndës së sharruar sipas kriterëve të caktuara.
- Matja e lëndës së sharruar
- Llogaritja e vëllimit të lëndës së sharruar.
- Stivimi i lëndës së sharruar.
- Vendosja e tabelave në stiva.
- Llogaritja e sipërfaqes së depozitës.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës së sharruar.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë sheshin e depozites sipas skicës, dhe paisjet e nevojshme në të.
- të marrë në dorëzim lëndën e sharruar sipas rregullave.
- të kontrollojë lëndën e sharruar në përputhje me standartin.
- të masë me kujdes, sipas kërkesës, lëndën e sharruar;
- të llogaritë saktë vëllimin e lëndës së sharruar;
- të kryejë procese pune për të ndarë lëndën e sharruar sipas kriterëve të caktuara, llojit, pozicionit të rrathëve vjetorë,

- vëndit që zë në trup, përmasave etj.
- të kryejë procese pune për të stivuar sipas kërkesave lëndën e sharruar dhe të vendosi tabela ku tregohen karakteristikat e saj.
 - të llogarisë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh, sipërfaqen me stiva të lëndës së sharruar me rrugë komunikimi dhe hapësira ajrimi.
 - të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në procese pune, në depozitën e lëndës të sharruar.

RM 7 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e një m³ lëndë e sharruar

Përmbajtja

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e lëndës së sharruar.
- Kostot në punimet e lëndës së sharruar.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Prodhime druri gjysmë të gatëshme”, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël “Prodhime druri gjysmë të gatëshme” gjatë prodhimit të lëndës të sharruar.
- Hartim i preventivit për materiale në prodhimin e lëndës të sharruar.
- Përgatitja e faturës për procesin e kryer në prodhimin e 1 (një) m³ lëndë të sharruar.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale
- Marketingu i lëndës të sharruar (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën)

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e 1 (një) m³ lëndë të sharruar.
- të përcaktojë koston në punimin e lëndës së sharruar.
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogarisë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).
- të llogarisë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit

“Prodhime druri gjysmë të gatshme”.

- të llogarisë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël “Prodhime druri gjysmë të gatshme” gjatë prodhimit të lëndës së sharruar.
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e një m³ lënde të sharruar.
- Përgatitja e faturës, për koston e 1 (një) m³ lënde të sharruar.
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të njohë marketingun e lëndës të sharruar (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyën e shpërndarjes së produktit, reklamën).

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të lëndës të sharruar.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për prodhimin e lëndës të sharruar, të organizojë edhe vizita në fabrika apo punishte ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për prodhimin e lëndës së sharruar.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për prodhimin e lëndës të sharruar, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e lëndës të sharruar.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e lëndës të sharruar.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart, fabrikë për punime të prodhimit të lëndës të sharruar.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të prodhimit të lëndës të sharruar.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Trupa druri, binarë, lëndë e sharruar.
 - Skica e skemës të procesit teknologjik të repartit të prodhimit të lëndës të sharruar, modeleve të pterjes, skema të punës të makinave gatër, sharrë shirit etj.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesat,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

6. Moduli “Punime për prodhimin e pllakës panel”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme.
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME PËR PRODHIMIN E PLLAKËS PANEL	(M-09-1455-18)
Qellimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer punime për prodhimin e pllakës panel.	
Kohezgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e te mesuarit (RM), Permbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi kryen punime për përgatitjen e vendit të punës Përmbajtja</p> <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i planimetrisë, vendosjes së makinave sipas rradhës së punës për prodhimin e pllakës panel.– Skicimi i modelit të mesores të pllakës panel.– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i rradhës së punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zgjedhja e lëndës të parë.– Zgjedhja e paisjeve, makinave prerëse të nevojshme.– Zgjedhja e mjeteve ngarkuese dhe transportuese.– Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerëse, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punishten, fabrikën e prodhimit të pllakës panel <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e realizimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të skicojë planimetrinë, vendosjen e makinave sipas rradhës së punës për prodhimin pllakës panel me të gjitha proceset sipas rradhës.– të skicojë modelin e mesores të pllakës panel sipas kërkesës.– të analizojë vizatimet e planimetrisë vendosjes së makinave sipas rradhës së punës për prodhimin e pllakës	

-
- panel, skica të modeleve të mesores prej rripash druri, mbetje rimeso teknike, bllok dërrasa të ngjitura etj.
 - të përcaktojë radhën e punës që nga skela e shkarkimit deri te markëtimi i pllakës panel.
 - të organizojë vendin e punës, sipas kërkesave, në të gjitha pjesët e procesit teknologjik të prodhimit të pllakës panel.
 - të zgjedhë lëndën e parë, (riipa druri,mbetje compensate, dërrasa etj).
 - të zgjedhë paisjet, makinat prerëse të nevojshme si për përgatitjen e mesores të pllakës panel, shtresës sipërfaqore, ngjitjes, presimit, përpunimit përfundimtar etj.
 - të zgjedhë mjetet ngarkuese dhe transportuese, sipas kërkesës, për të lëvizur, materialin në të gjitha proceset.
 - të zgjedhë mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese sipas kërkesës.
 - të dërgojë materialet, pajisjet prerëse, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në fabrikën e prodhimit të pllakës panel.

RM 2 Nxënësi kryen punime në depozitën e lëndës së parë për prodhimin e pllakës panel.

Përmbajtja

- Kontrolli i sheshit të depozites sipas skicës.
- Marja në dorëzim e lëndës së parë si mbetje druri, mbetje rimeso teknike, dërrasa etj.
- Kontrolli i lëndës të parë në përputhje me kushtet teknike si lloji, lagështira, përmasat etj.
- Stivimi i lëndës të parë sipas asortimenteve.
- Vendosje e tabelave në stiva.
- Kujdesi për veglat, pajisjet,makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës të parë për prodhimin e pllakës panel.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë sheshin e depozites sipas skicës,në ndërtim, në pastërti, për disinfektim, për paisjet e nevojshme, ngarkuese dhe shkarkuese.
- të marrë në dorëzim lëndën duke kontrolluar llojin, lagështirën, përmasat etj, sipas kushteve teknike.
- të kryejë procese pune për stivimin e lëndës së parë sipas rregullave të caktuara;
- të vendosë tabelat në stiva sipas asortimenteve të lëndës së

parë.

- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune, në depozitën e lëndës së parë për prodhimin e pllakës panel.

RM 3 Nxënësi kryen punime në makineri për prodhimin e pllakës panel.

Përmbajtja

- Përgatitja e makinës për punë.
- Matja dhe shënimi i lëndës të parë.
- Shkurtimi i dërrasës.
- Punimi në makinën plan i dërrasave.
- Punimi në makinën grosecë.
- Punimi në sharra rrethore me shumë disqe.
- Ndarja e rripave të drurit sipas cilësisë.
- Shkurtimi i pjesëve me difekte në rripat e durit.
- Prerja e blloqeve të dërrasave të ngjitura dhe të presuara.
- Prerja e fletëve të rimesos teknike.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në makineri për prodhimin e pllakës panel.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë makinat për punë, shkurtuese të dërrasave, plan dhe grosetë, sharrimi në gjatesi me shumë disqe, për prerje të rimesos etj.
- të kryejë procese pune për matjen dhe shënimin në dërrasat, rripat e drurit, rimesot e prera sipas skicës.
- të kryejë procese pune për të shkurtuar dërrasat në gjatësinë e këkuar në makinat me disk thikëmbajtës.
- të kryejë procese pune që të realizohet zdrukthimi i dërrasave në një faqe dhe brinje në makinën plan.
- të kryejë procese pune për të realizuar nxjerrjen në trashësi të dërrasës, sipas kërkesës, në makinën grosecë.
- të kryejë procese pune për të sharruar dërrasat, në makinën sharrë rrethore me shumë disqe, me dhëmbë të vegjël dhe të barazlanguara mes tyre sipas trashësisë të brëndëshme të pllakës panel.
- të ndajë rripat e drurit sipas cilësisë.
- të kryejë procese pune për të shkurtuar, pjesët me difekte, në rripat e durit.
- të kryejë procese pune për të sharruar blloqet e dërrasave të ngjitura dhe të presuara në rripa druri në sharrë shirit, kur

- mesi i pllakës formohet prej tyre.
- të kryejë procese pune për të prerë fletët e rimesos teknike për faqe, për mesore në rast se mesorja bëhet prej tyre, në makina gërsherë ose sharrë me shumë disqe.
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas standartit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në makineri për prodhimin e pllakës panel.

RM 4 Nxënësi kryen punime për ngjitjen dhe presimin e pllakës panel.

Përmbajtja

- Përgatitja e makinës të lyerjes me lëndë ngjitëse.
- Përgatitja e presës për punë.
- Kontrolli i elementeve të pllakës panel.
- Lyerja me lëndë ngjitëse.
- Formimi i paketave.
- Furnizimi i presës me paketa paneli.
- Presimi i pllakës panel.
- Shkarkimi i presës.
- Kontrolli i cilësisë të punimeve
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune për ngjitjen dhe presimin e pllakës panel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përgatitë paisjet, apo makinën e lyerjes me lëndë ngjitëse duke rregjistruar dhe furnizuar atë.
- të përgatitë presën për punë.
- të kontrollojë elementët e pllakës panel për mesore dhe faqe sipas standartit.
- të kryejë procese pune për të lyer me lëndë ngjitëse sipas kushtit teknik mesoren, faqen e jashtëme të rimesos.
- të formojë sipas modelit paketën e panelit mbi fletën e aluminit.
- të kryejë procese pune për të furnizuar presën me paketa paneli me ndihmën e ashensorit ngarkues.
- të kryejë procese pune për të presuar panelin, me rregjim sipas parametrave të caktuara.
- të shkarkojë presën sipas rradhës, nga pllakat panel.
- të kontrollojë cilësinë e punimeve sipas standartit.
- të kujdeset për veglat dhe paisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune për ngjitjen dhe presimin e

pllakës panel.

RM5 Nxënësi kryen punime përfundimtare të pllakës panel

Përmbajtja

- Ftohja e pllakës panel.
- Formatizimi i pllakës panel.
- Kalibrimi i pllakës panel.
- Përpunimi i sipërfaqes të pllakës panel.
- Përpunimi i brinjëve të pllakës panel.
- Markëtimi i pllakës panel.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes të mjedisit gjatë kryerjes të operacioneve përfundimtare në prodhimin e pllakës panel.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

- të kryejë procese pune për ftohjen e pllakave panel në mënyrë natyrale në stiva.
- të kryejë procese pune për formatizimin e pllakës panel, sipas përmasave në skicë, me makina skuadruese me dy disqe.
- të kryejë procese pune për të kalibruar pllakën panel, në makinat e kaibrimit, për të marrë trashësinë sipas standartit.
- të kryejë procese pune për të përpunuar sipërfaqen e pllakës panel duke e përmirësuar atë sipas kërkesës, rimesim, patinim etj.
- të kryejë procese pune për të përpunuar brinjët e pllakës panel, sipas kërkesës, me rimeso, plastikë etj.
- të kryejë procese pune për të markëtuar pllakën panel sipas kërkesave.
- të kujdeset për veglat paisjet dhe makinat.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes të mjedisit gjatë operacioneve përfundimtare të prodhimit të pllakës panel.

RM 6 Nxënësi kryen llogaritje të thjeshta ekonomike për prodhimin e 1metër katror pllakë panel

Përmbajtja

- Llogaritjet ekonomike për prodhimin e 1(një) m² pllakë panel.
- Kostot në punimet e pllakës panel.
- Preventivi i materialeve, kostoja për materialet.
- Kostoja e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- Kosto të tjera (transport, energji, amortizim pajisjesh, etj.).

- Detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Prodhime druri gjysmë të gatëshme”, llogaritja e tyre.
- Të ardhurat, fitimi, llogaritja e fitimit në një biznes të vogël “Prodhime druri gjysmë të gatëshme” gjatë prodhimit të pllakës panel.
- Hartim i preventivit për materiale në prodhimin e një m² pllakë panel.
- Përgatitja e faturës, për procesin e kryer në prodhimin e pllakës panel.
- Komunikimi me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- Marketingu i pllakës panel (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën)

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të realizojë llogaritjet ekonomike për prodhimin e një m² pllakë panel.
- të përcaktojë koston në punimin e pllakës panel.
- të përcaktojë preventivin e materialeve, koston për materialet.
- të llogaritë koston e punës (pagat, sigurimet shoqërore, etj.).
- amortizim pajisjesh, etj.)
- të përcaktojë kosto të tjera (transport, energji).
- të llogarisë detyrimet fiskale në bizneset e vogla të profilit “Prodhime druri gjysmë të gatëshme”.
- të llogarisë të ardhurat, fitimin në një biznes të vogël “Prodhime druri gjysmë të gatëshme” gjatë prodhimit të pllakës panel.
- të hartojë preventivin (për materiale) përfundimtar për prodhimin e pllakës panel.
- Përgatitja e faturës, për koston e 1 m² pllakë panel;
- të komunikojë me profesionalizëm dhe me etikë profesionale.
- të njohë marketingun e pllakës panel (studimi i tregut të shitjes, përcaktimi i cmimit, mënyrën e shpërndarjes së produktit, reklamën).

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të pllakës panel.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për prodhimin e pllakës panel, të organizojë edhe vizita në fabrika apo punishte ku nxënësit të shohin konkretisht

teknologjinë e prodhimit të pllakës panel.

- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve për prodhimin e pllakës panel, fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për prodhimin e pllakës panel.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të punës për prodhimin e pllakës panel.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për punime të prodhimit të pllakës panel.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të prodhimit të pllakës panel.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Dërrasa, rripa druri, mbetje rimeso teknike.
 - Skica e skemës të procesit teknologjik të repartit të prodhimit të pllakës panel, skema të modeleve të mesores të pllakës panel etj.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

7. Moduli: “Punime për përmirësimin e sipërfaqes së pllakës.”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme
Niveli: II
Klasa: 12

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	PUNIME PËR PËRMIRËSIMIN E SIPËRFAQES SË PLLAKËS	(M-09-1456-18)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime për përpunimin dhe veshjen e sipërfaqes së pllakës gjysmë të gatshme prej druri.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përmbajtja: <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i punimeve të ndryshme– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i radhës së punës.– Zgjedhja e pllakave.– Zgjedhja e materialeve të nevojshme.– Zgjedhja e makinave përkatëse.– Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerese, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. Instrumentet e vlerësimit: Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit: Nxënësi duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve për përmirësimin e sipërfaqes në pllaka zdrukthi, fibre, panel etj.– të përshkruajë saktë radhën e punimeve.– të zgjedhë pllakën sipas përdorimit dhe trajtimit që do kryhet.– të zgjedhë sipas procesit të punës makinën e përpunimit;– të zgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese.	

-
- të vendosë me kujdes, materialin pranë makinës.
 - të organizojë vendin e punës sipas rregullave.
 - të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për kryerjen e punimeve në sipërfaqen e pllakës si ftohje, njomje, patinime, lysterje, melaminime, rimesime.

RM 2 Nxënësi kryen punime për ftohjen e pllakave.

Përmbajtja:

- Rregjistrimi i pajisjeve për rregullimin e parametrave të ajrit për ftohje.
- Kontrolli i parametrave të ajrit në sektorin e ftohjes
- Stivimi i pllakave mbas presimit
- Kontrolli i punimit.
- Kujdesi për veglat, pajisjet e ftojes.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të ftohjes së pllakave.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të rregjistrojë pajisjet për rregullimin e parametrave të ajrit për ftohje si kaloriferët, ventilatorët etj.
- të kontrollojë parametrat e ajrit si temperaturën, lagështirën relative me aparatet e kontrollit, si termometër etj.
- të stivojë sipas kërkesave pllakat që dalin nga presa.
- të kontrollojë pllakat kompensatën, drurin e shtresuar, pllakën e zdrukthit, fibrës, panel, qelizore pas ftohjes sipas standartit.
- të kujdeset për veglat, pajisjet e ftohjes.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë procesit të ftohjes së pllakave si kompensatën, drurin e shtresuar, pllakën e zdrukthit, fibrës, panel, qelizore pas ftohjes sipas standartit

RM 3 Nxënësi kryen punime të njomjes së pllakave të zdrukthit, fibrës.

Përmbajtja:

- Rregjistrimi i pajisjes, makinës së njomjes.
- Vendosja e pllakës në paisjen, makinën e njomjes.
- Njomja e pllakës.
- Kontrolli i parametrave të pllakës mbas njomjes.
- Kujdesi për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës të njomjes së pllakave të zdrukthit, fibrës.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të rregjistrojë pajisjen, makinën e njomjes sipas punës që do kryejë.
- të vendosë, me kujdes, pllakat në paisjen, makinën e njomjes.
- të realizojë njomjen e pllakave për të aritur lagështirën sipas kërkesës.
- të kontrollojë lagështirën e aritur të pllakës mbas njomjes;
- të kujdeset për makinat, pajisjet dhe instrumentet në sektorin e njomjes së pllakave.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës të njomjes së pllakave të zdrukthit, fibrës.

RM 4 Nxënësi kryen punime të patinimit, ngjyrimit të pllakave.

Përmbajtja:

- Përcaktimi i ngjyrës, mënyrës së patinimit
- Përgatitja e pllakave për ngjyrim, patinim
- Rregjistrimi i mjetit apo makinës së ngjyrosjes, patinimit.
- Realizimi i ngjyrosjes, patinimit.
- Kontrolli i i ngjyrës dhe cilësisë së patinimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet e ngjyrosjes dhe patinimit të pllakave.
- ***strumentet e vlerësimit:***
 - Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të përcaktojë ngjyrën, mënyrën e patinimit të pllakave.
- të përgatitë pllakën për ngjyrim, patinim sipas kërkesës.
- të rregjistrojë mjetin apo makinën për ngjyrosjen, patinimin me cilësinë e duhur të pllakave.
- të realizojë me kujdes ngjyrosjen, patinimin e pllakave.
- të kontrollojë ngjyrën dhe cilësinë e patinimit sipas modelit.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet e ngjyrosjes dhe patinimit të pllakave.

RM 5 Nxënësi kryen punime ilustrimi, rimesimi, melaminimi të pllakave.

Përmbajtja:

- Kontrolli i sipërfaqes së pllakës.
- Kontrolli i materialit që do aplikohet mbi sipërfaqen e pllakës.
- Përgatitja e lëndës ilustruese sipas recetave.
- Përcaktimi i metodës së aplikimit të ilustrës.
- Përgatitja e materialit që do vishet sipërfaqja dhe brinjët e pllakës.
- Veshja e sipërfaqes së pllakës.
- Veshja e brinjëve të pllakës.
- Kontrolli i punimeve të bëra.

- Kujdesi për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës së ilustrimit, rimesimit, melaminimit të pllakave.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të kontrollojë sipërfaqen dhe binjët e pllakës para aplikimit të ilustrës, rimesos, melaminës etj;
- të kontrollojë lloin dhe cilësinë e materialit që do aplikohet mbi sipërfaqen dhe brinjët e pllakës sipas skicës.
- të kryejë procese pune të përgatitjes së lëndës ilustruese sipas recetave.
- të përcaktojë metodën e aplikimit të ilustrës, sipas modelit.
- të kryejë procese pune në përgatitjen e materialit që do vishet sipërfaqja e pllakës.
- të veshë sipërfaqen e pllakës me rimeso, melaminë etj sipas skicës.
- të veshë brinjët e pllakës me rimeso, melaminë etj sipas skicës.
- të kontrollojë ilustrimin, veshjen me rimeso, melaminimin e faqeve dhe brinjëve të pllakave sipas modelit.
- të kujdeset për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- të zbatojë rregullat e të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës së ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të pllakave gjysmë të gatëshme prej druri.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete të proceseve të punës së ftohjes, njomjes, ngjyritit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre;
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, të proceseve të punës, së ftohjes, njomjes, ngjyritit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre;
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës së ftohjes, njomjes, ngjyritit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre;
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e proceseve të punës, së ftohjes, njomjes, ngjyritit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre;
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e

kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin si duhet, të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:

- Mjedise të praktikës së përpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me makinat e ftohjes, njomjes, ngjyrimit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre.
 - Kompletimi i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune së ftohjes, njomjes, ngjyrimit, patinimit, ilustrimit, rimesimit, melaminimit të sipërfaqes së pllakave dhe brinjëve tyre.
 - Skica të proceseve.
 - Lëndë e parë.
 - Katalloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

8. Moduli: “Punime përfundimtare me makina ”

Drejtimi: Përpunim druri

Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme

Niveli: II

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PUNIME PËRFUNDIMTARE ME MAKINA	(M-09-1457-18)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime përfundimtare pllakave të zdrukthit, fibres, panel etj, me makina të kalibrimit, skuadrimin, shpimit, frezimit, dhe thithëzimit.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar modulet e praktikës profesionale të drejtimit “Përpunim druri”, niveli I	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i punimeve të ndryshme.– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i radhës së punës.– Zgjedhja e pllakave.– Zgjedhja e makinave përkatëse.– Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerese, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit. <p>Instrumentet e vlerësimit:</p> <p>Vëzhgim me listë kontrolli.</p> <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të analizojë dhe interpretojë vizatime dhe skica të punimeve me makina në pllaka zdrukthi, fibre, panel etj;– të përshkruajë saktë radhën e punimeve;– të zgjedhë pllakën sipas përdorimit dhe dhënies së formës;– të zgjedhë sipas procesit të punës makinën e përpunimit;– të të zgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;– të vendosë me kujdes, materialin pranë makinës;– të organizojë vendin e punës sipas rregullave;– të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës përgatitore për kryerjen e punimeve	

përfundimtare në pllaka me makina kalibrimi, skuadrimi, birimi, thithëzimi, frezimi.

RM 2 Nxënësi kryen punime në pllaka me makinat e kalibrimit.

Përmbajtja:

- Matja dhe shënimi i trashësisë sipas skicës.
- Gradimi i makinës kalibruese.
- Vendosija e pllakës në makinë.
- Avancimi i pllakës dhe kalibrimi i saj.
- Kontrolli i punimit .
- Kujdesi për veglat, pajisjet dhe makinat e kalibrimit.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet e pllakave me makinat e kalibrimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të masë dhe të shënojë elementet sipas skicës;
- të gradojë makinën e kalibrimit sipas trashësisë të standartit për pllakën;
- të kryejë proce pune për kalibrimin me një kalim të pllakës në makinë;
- të kontrollojë punimin e bërë sipas standartit;
- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe makinat e kalibrimit;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet e pllakave, me makinat e kalibrimit;

RM 3 Nxënësi kryen punime me pllaka me makinat e skuadrimit.

Përmbajtja:

- Matja dhe shënimi në pllakë.
- Rregjistrimi i makinës.
- Skuadrimi i pllakave në gjatësi.
- Skuadrimi i pllakave në gjërësi.
- Skuadrimi i pllakave me një kalim në të dy drejtimet
- Kontrolli i punimeve të bëra.
- Kujdesi për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës me makinat gjatë skuadrimit.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe të shënojë mbi pllakë sipas skicës.
- të rregjistrojë makinën e skuadrimit një apo dy anësore.
- të kryejë procese pune për profilimin e pllakave sipas modelit.

- të kryejë procese pune për skuadrimit horizontal të pllakës sipas përmasave në skicë.
- kryejë procese pune në skuadrimit vertikal të pllakave sipas modelit.
- të kryejë procese skuadrimit në dy drejtimet njëherësh në makinën e skuadrimit.
- të kontrollojë punimet e bëra me mjete kontrolli sipas skicës apo modelit.
- të kujdeset për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimin e pllakave me makinat e skuadrimit.

RM 4 Nxënësi kryen punime në pllaka me makinat e shpimit.

Përmbajtja:

- Matja dhe shënimi në pllaka sipas skicës.
- Rregjistrimi i makinës.
- Shpimet vertikale me shumë punto.
- Shpimet horizontale me shumë punto.
- Kontrolli i shpimeve të bëra.
- Kujdesi për veglat, pajisjet dhe makinat e shpimit me shumë punto.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në punimet me pllaka në makinat e shpimit me shumë punto.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të matë dhe të shënojë elementet sipas skicës.
- të kryejë procese pune, për shpimet vertikale të pllakave, në makinat e shpimit me shumë punto.
- të kryejë procese pune, për shpimet horizontale të pllakave, në makinat e shpimit me shumë punto.
- të kontrollojë sipas modelit shpimet e bëra me makina, në pllaka, sipas skicës.
- të kujdeset për veglat, pajisjet dhe makinat e shpimit me shumë punto.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë punimeve, për shpimet horizontale dhe vertikale të pllakave, në makinat e shpimit me shumë punto.

RM 5 Nxënësi kryen punime me pllaka me makinat frezë.

Përmbajtja:

- Matja dhe shënimi në pllakë.
- Rregjistrimi i makinës
- Profilimi i pllakave.
- Hapja e kanaleve.

- Bërja e shkallëzimeve (paturave).
- Hapja e foleve me frezë zinxhir.
- Kopjimi i modelit me frezë kopjuese.
- Kontrolli i punimeve të bëra.
- Kujdesi për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë punës me makinat e frezimit.

Instrumentet e vlerësimit:

Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë :

- të matë dhe të shënojë mbi pllakë sipas skicës;
- të regjistrojë makinën frezë sipas vecorisë të saj
- të kryejë procese pune për profilimin e pllakave sipas modelit.
- të kryejë procese pune për hapjen e kanaleve sipas përmasave në skicë.
- kryejë procese pune në realizimin e shkallëzimeve të pllakës sipas modelit.
- të kryejë procese pune për hapjen e foleve me freze zinxhir.
- të kryejë procese pune për realizimin e kopjimit të modelit me freze kopjuese, në pllakë.
- të kontrollojë punimet e bëra me mjete kontrolli sipas skicës apo modelit.
- të kujdeset për makinat, pajisjet dhe instrumentet.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimin e pllakave me makinat e frezimit.

RM 6 Nxënësi kryen punime me makinat e thithëzimit.

Përmbajtja:

- Rregjistrimi i makinës së thithëzimit, sipas skicës.
- Punimi i pllakave në makinën një anësore të thithëzimit.
- Punimi i pllakave në makinën dy anësore të thithëzimit.
- Kontrolli i punimeve të bëra.
- Mirëmbajtja e makinave, pajisjeve dhe instrumentave prerës.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimin e pllakave me makinat e thithëzimit.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të regjistrojë makinën e thithëzimit, sipas skicës
- të kryejë procese pune për realizimin e punimit të pllakave në makinën e thithëzimit njëanësore sipas skicës.

- të kryejë procese pune për realizimin e punimit të pllakave në makinën e thithëzimit dy anësore sipas skicës.
- të kontrollojë punimet e bëra në pllaka me makinat e thithëzimit sipas skicës.
- të mirëmbajë makinat, pajisjet dhe instrumentat prerës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit në punimet e pllakave me makinat e thithëzimit.

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të pllakave gjysmë të gatëshme prej druri.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete së proceseve të punës me makina të kalibrimit, skuadrimit, shpimit, frezimit, thithëzimit të drurit.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete, së proceseve të punës, me makina të kalibrimit, skuadrimit, shpimit, frezimit të drurit dhe të, thithëzimit.
- Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me proceset e punës me makina të kalibrimit, skuadrimit, shpimit, frezimit të drurit dhe të, thithëzimit.
- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike, për realizimin e proceseve të punës, me makina të kalibrimit, skuadrimit, shpimit, frezimit të drurit dhe të, thithëzimit.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, dhe materialet e mëposhtme:
- Mjedise të praktikës së perpunimit të drurit me poste pune për realizimin e proceseve të punës me makina të kalibrimit, shpimit, frezimit të drurit dhe të thithëzimit.
 - Komplet i veglave, pajisjeve dhe materialeve të nevojshme për procese pune me makina të kalibrimit, shpimit, frezimit të drurit dhe të, thithëzimit.
 - Skica të proceseve.
 - Lëndë e parë.
 - Kataloge, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

X. Përshkruesit e moduleve të praktikës profesionale me zgjedhje të detyruar

1. Moduli “Formimi i qilimit me zdrukthe dhe fibra druri”

Drejtimi: Përpunim druri
Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme.
Niveli: II
Klasa: 12

PERSHKUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	FORMIMI I QILIMIT ME ZDRUKTHE DHE FIBRA DRURI	(M-09-498-10)
Qëllimi i modulit	Një modul praktik që i aftëson nxënësit për të kryer procese pune në makinat e formimit të qilimit me zdrukthe dhe fibra druri.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Përpunim druri”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës Përmbajtja <ul style="list-style-type: none">– Përshtatja e vendit të punës.– Skicimi i makinës të formimit të qilimit me zdrukthe, fibra.– Zbërthimi i skicës.– Përzgjedhja e materialeve.– Zgjedhja e veglave, pajisjeve dhe makinave për formimin e qilimit me zdrukthe, fibra druri.– Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për formimin e qilimit me zdrukthe, fibra druri. Instrumentet e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. Kriteret e vlerësimit <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të organizojë vendin e punës për procese pune të formimit të qilimit me zdrukthe, fibra druri;– të skicojë skemën e punës të makinës të formimit;– të zbërthejë skicën në sektorët përkatës të makinës të formimit të qilimit me zdrukthe ose me fibra druri;– të përzgjedhë materialet e nevojshme për formimin e qilimit me zdrukthe ose fibra druri;– të përgatisë veglat, pajisjet dhe makinat për formimin e	

qilimit me zdrukthe ose fibra druri;

- të zbatojë drejt rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për formimin e qilimit me zdrukthe ose fibra druri;
-

RM 2 Nxënësi formon qilim me zdrukthe në makinën e formimit për pllakë zdrukthi një ose tre shtresore

Përmbajtja

- Regjistrimi i linjës të formimit të qilimit me zdrukthe
- Kontrolli i dozimit dhe shpërndarjes të zdruktheve.
- Kontrolli i lëvizjes të pllakës ku formohet qilimi me zdrukthe.
- Furnizimi i makinave të formimit me zdrukthe.
- Formimi i qilimit me zdrukthe.
- Transportimi i qilimit në presën e ftohtë.
- Kujdesi për veglat dhe pajisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për formimin e qilimit me zdrukthe druri.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kryejë procese pune për regjistrimin e linjës së formimit të qilimit me zdrukthe, makinat formuese, lëvizjen e transportierit sipas kërkesës;
- të kontrollojë dozimin dhe shpërndarjen që në qyrim të bëhet vendosja e njëtrajtëshme e një sasi të caktuar zdrukthesh;
- të kontrollojë lëvizjen e pllakës ku formohet qilimi që të marrë nga makinat formuese në të gjitha pikat e sipërfaqes sasi të njëjtë zdrukthesh;
- të kujdeset për furnizimin e rregullt të makinave të formimit me zdrukthe të lyera me lëndë ngjitëse;
- të kryejë procese pune për formimin e qilimit me zdrukthe sipas standartit;
- të kryejë procese pune të transportimit të qilimit në presën e ftohtë në kohën e caktuar;
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës;.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë proceseve të punës për formimin e qilimit me zdrukthe druri.

RM 3 Nxënësi formon qilim me fibra druri në makinën formuese me sitë të gjatë ose me sitë të rrumbullakët

Përmbajtja

- Regjistrimi i linjës të formimit të qilimit me fibra druri
- Kontrolli i masës të fibrave të drurit.
- Kontrolli i sektorëve perbërës të linjës të formimit të

- qilimit me fibra drunore.
- Furnizimi i makinave të formimit me masën e fibrave drunore.
- Formimi i qilimit me fibra drunore.
- Transportimi i qilimit në procese të tjera.
- Kontrolli i qilimit me zdrukthe druri sipas kushteve teknike.
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
- Rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për formimin e qilimit me fibra druri në makinën e formimit me sitë të gjatë ose të rrumbullakët.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e vlerësimit

Nxënësi duhet të jetë i aftë

- të kryejë procese pune për regjistrimin e linjës së formimit të qilimit me fibra druri në të gjitha sektorët përbërës të saj sipas kërkesave.
- të kontrollojë masën e fibrave drunore për temperaturën, shkallën e defibrimit, aciditetin sipas kërkesës.
- të kontrollojë punën në të gjithë sektorët e makinës të formimit, sipas kushteve teknike.
- të kryejë procese pune për furnizimin e rregullt të makinave të formimit me masën e fibrave drunore, të lyera me kimikate.
- të kryejë procese pune për formimin e qilimit me fibra druri sipas standartit.
- të kryejë procese pune për transportimin e qilimit me fibra druri në procese të tjera.
- të kontrollojë cilësinë e qilimit me fibra druri, sipas kërkesës.
- të kujdeset për veglat dhe pajisjet e punës.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punimeve për formimin e qilimit me fibra druri në makinën me sitë të gjatë ose të rrumbullakët;

Udhëzime për zbatimin e modulit

- Ky modul duhet të trajtohet në repartin e punës si dhe në punishte apo fabrika të prodhimit të pllakave të zdrukthit, fibrës.
- Mësuesi i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur demonstrimet konkrete për kryerjen e proceseve të punës për formimin e qilimit me zdrukthe dhe ashkla druri në makinat e formimit me sitë të gjatë ose të rrumbullakët, të organizojë edhe vizita në fabrika apo punishte ku nxënësit të shohin konkretisht proceset e punës për formimin e qilimit me zdrukthe, fibra druri.
- Nxënësit duhet të angazhohen në veprimtari konkrete pune për kryerjen e punimeve në formimin e qilimit me zdrukthe, fibra druri fillimisht në mënyrë të mbikqyrur dhe më

pas në mënyrë të pavarur. Ata duhet të nxiten të diskutojnë në lidhje me procedurat e punës për formimin e qilimit me zdrukthe, fibra druri në makinat e formimit.

- Gjatë vlerësimit të nxënësve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike për realizimin e proceseve të formimit të qilimit me zdrukthe dhe ashkla druri në makinat formuese.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kritereve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të mësuarit.

Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit

Për realizimin e pranueshëm të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet, makinat dhe materialet e mëposhtme:

- Repart për punime të prodhimit të pllakave të zdrukthit dhe fibrave.
 - Kompleti i veglave, pajisjeve dhe makinave të formimit të qilimit me zdrukthe dhe fibra druri.
 - Instrumenta shënuese, matëse dhe kontrolluese.
 - Zdrukth dhe masë fibre druri të lyera me kimikate të dhe materiale ndihmëse për prodhim.
 - Skica e sektorëve të punës në makinat e formimit të qilimit me zdrukthe, fibra druri.
 - Mjete ilustruese, materiale të shkruara, udhëzuesa,
 - Kompleti i veshjeve të punës.
-

2. Moduli “Prodhimi i pllakës së fibrës me dendësi mesatare M.D.F.”

Drejtimi: Përpunim druri

Profili: Prodhime druri gjysmë të gatshme

Niveli: II

Klasa: 12

PERSHKRUESI I MODULIT

Titulli dhe kodi	PRODHIMI I PLLAKËS SË FIBRËS ME DENDËSI MESATARE M.D.F.	(M-09-499-10)
Qëllimi i modulit	Një modul që aftëson nxënësit për të kryer punime për prodhimin e pllakës së fibrës me dendësi mesatare M.D.F.	
Kohëzgjatja e modulit	51 orë mësimore	
Niveli i parapëlqyer për pranim	Nxënësit duhet të kenë përfunduar nivelin I të drejtimit mësimor “Përpunim druri”	
Rezultatet e të mësuarit (RM), përmbajtja dhe procedurat e vlerësimit	<p>RM 1 Nxënësi përgatit vendin e punës</p> <p>Përmbajtja:</p> <ul style="list-style-type: none">– Skicimi i planimetrisë, vendosjes së makinave sipas radhës së punës për prodhimin e pllakës M.D.F.– Analiza e vizatimeve dhe skicave.– Përcaktimi i radhës së punës.– Zgjedhja e lëndës të parë që nevojitet për prodhimin e pllakës M.D.F.– Zgjedhja e pajisjeve, makinave prerëse të nevojshme– Zgjedhja e mjeteve ngarkuese dhe transportuese .– Zgjedhja e mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese.– Dërgimi i materialeve, pajisjeve prerëse, mjeteve matëse, shënuese dhe kontrolluese në vendin e punës.– Organizimi i vendit të punës.– Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe ruajtjes së mjedisit gjatë prodhimit të pllakës M.D.F. <p>Instmentet e vlerësimit:</p> <ul style="list-style-type: none">– Vëzhgim me listë kontrolli. <p>Kriteret e vlerësimit:</p> <p>Nxënësi duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none">– të skicojë planimetrinë, vendosjen e makinave sipas radhës së punës për prodhimin e pllakës M.D.F.– të analizojë dhe interpretojë vizatimet dhe skicat e planimetrisë, për prodhimin e pllakës M.D.F., modele të pllakës, punime të thjeshta në lëndën e parë etj;– të përcaktojë saktë radhën e operacioneve të punës për prodhimin e pllakës M.D.F.;– të zgjedhë lëndën e parë, mbetje druri për pllakën M.D.F.	

dhe lëndë të tjera ndihmëse për prodhimin e pllakës M.D.F.;

- të zgjedhë pajisjet, makinat prerëse të nevojshme;
- të zgjedhë sipas kërkesës, mjetet matëse, shënuese dhe kontrolluese;
- të zgjedhë mjetet ngarkuese dhe transportuese të nevojshme
- të organizojë vendin e punës sipas rregullave;
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të ruajtjes së mjedisit gjatë punës për prodhimin e pllakës M.D.F.

RM 2 Nxënësi kryen punime në depozitën e lëndës të parë për prodhimin e pllakës të fibrës M.D.F.

Përmbajtja

- Marja në dorëzim e lëndës së parë mbetje druri.
- Ndarja e mbetjeve sipas asortimentit.
- Kontrolli i asortimenteve të lëndës të parë në përputhje me kushtet teknike.
- Ndarja e lëndës rezervë.
- Matja e asortimenteve të lëndës të parë për pllakë fibre.
- Stivimi i lëndës të parë sipas asortimenteve.
- Vendosja e tabelave treguese në cdo stivë.
- Njomja e materialit me ujë
- Trajtimi termik i lëndës të parë.
- Heqja e lëvores para copetimit.
- Llogaritja e sipërfaqes të depozitës.
- Kujdesi për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- Zbatimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës të parë për pllakë M.D.F.

Instrumentet e vlerësimit:

- Vëzhgim me listë kontrolli.

Kriteret e realizimit:

Nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të kontrollojë sheshin e depozites sipas skicës në ndërtim, në pastërti, për disinfektim, për pajisjet e nevojshme, ngarkuese dhe shkarkuese etj;
- të kryejë procese pune për marrjen në dorëzim të lëndës së parë, mbetje druri;
- të kryejë procese pune për ndarjen e mbetjeve sipas asortimentit;
- të kryejë procese pune për kontrollin e asortimenteve lëndës të parë, në përputhje me kushtet teknike;
- të kryejë procese pune për ndarjen e lëndës rezervë
- të matë asortimentet e lëndës të parë për pllakë fibre;
- të kryejë procese pune për stivimin e lëndës së parë sipas asortimenteve;

- të vendosë tabela treguese në cdo stivë.
- të kryejë procese pune për njomjen e materialit me ujë që të mbajë lagështirën e tij rreth 40%;
- të kryejë procese pune për realizimin e trajtimit termik të lëndës të parë, nëse është i nevojshëm;
- të kryejë procese pune për heqjen e lëvores nëse e lejon standarti;
- të llogaritë sipërfaqen e depozitës duke patur parasysh sipërfaqen e skelës të shkarkimit, rezervës të caktuar në rast remonti të fabrikës, sipërfaqe me stiva të asortimenteve të ndryshme dhe sipërfaqe me rrugë komunikimi dhe hapësira ajrimi;
- të kujdeset për veglat, pajisjet, makinat dhe mjetet ngarkuese dhe transportuese.
- të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit në procese pune në depozitën e lëndës të parë për pllakë M.F.D.

RM 3 Nxënësi kryen punime për prodhimin dhe seleksionimin e zdrukthit apo ashklave prej druri.

Përmbajtja

- Regjistrimi i makinës të copëtimit dhe seleksionimit të zdruktheve;
- Matja e lëndës të parë.
- Prerja e lëndës të parë në gjatësinë e kërkuar
- Furnizimi i makinës të copëtimit me lëndë të parë.
- Prodhimi i zdruktheve
- Seleksionimi i zdruktheve
- Kujdesi për veglat dhe paisjet e punës.
